

PALOK DAKA

KONTRIBUT PËR BIBLIOGRAFINË E GJUHËSISË SHQIPTARE (IV)

— 1910 —

563. — ABEJA Shqipe! (Marë nga fleta Rumanishte *Românul de la Pind*, që më 20 Shkurt, Nr. 8». — **KORÇA, Korçë 16 Mars 1910, Vit'i II-të, Nr. 1, fq. 4**
- Lajme mbi mbledhjen e mbajtur në Janinë në lidhje me shkronjat e alfabetit të shqipes. (Shkrue me alfabetin e «Stambollit»).
564. — ALFABETI. — **BASHKIMI, Shkodër, 20 Fruer 1910, Vjeta e I, Nr. 8 fq. 4.**
- Pasqyrzë e alfabetit të shqipes prej 26 shkronjash (në variantin shqip dhe arabisht) që përdor kjo gazetë. (Kjo pasqyrzë përsëritet në disa numra).
565. — ALFABETI Scyp. — **DILLI, Sunce. Sole, Skodra 2-X-1910, Mot'i I, Nr. 1, fq. 2.**
- Art. i redaksisë në favor të alfabetit të J. Jungut. (Shkrue me alf. e Autorëve të Vjetër të Veriut).
566. — ALFABETI shqip. (Kitojmë nga «Neologos» i Stambollit që më 8 mars këto): — **KORÇA, Korçë 16 Mars 1910, Vit'i II, Nr. 1, fq. 4 (3).**
- Kritikohen tendencat e disa grekomanëve dhe turkomanëve që kërkojnë t'i imponojnë gjuhës shqipe alfabetet greke a turke. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
567. — ALFABETI shqip dhe Enver Beu (Marë nga *Levant Herald-i*). — **FLAMURI, Boston, Mass. (USA) April 1, 1910, Vol. I, Nr. 7 fq. 1.**
- Artikull mbi deklaratën e Enver beut, personalitet xhonturk, dhanë në Londër në lidhje me qëndrimin e qeverisë xhonturke ndaj problemit të alfabetit të shqipes.
568. — ALFABETI dhe Shqipëtarët. — **DIELLI, Boston, Mass. (USA) April 22, 1910, Vit'i dytë, Vol. II, Nr. 56, fq. 1.**
- Lajme mbi disa demonstrata e mitingje të bame në Shqipni kundër alfabetit turk (marrë nga gazeta *Levant Herald*)
569. — ANDEJ — Këtej. — **KORÇA, Korçë 16 Mars 1910, Vit'i II, Nr. 1, fq. 4(3).**
- Lajme mbi dorëheqjen e Valiut të Kosovës, Mas'har beu, në shënjë proteste kundër alfabetit latin; mbi heqjen nga puna të drejtorit të Idadies në Shkup pse dha leje të mësohet shqipja me shkronja latine; mbi mitingjet në Berat e Përmet në mbrojtje të shkronjavet shqipe. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
570. — ANDEJ e Ktej. — **SHKREPTIMA, Kairo 14/27 Vjeshtë e Tretë, Vit'i I, Nr. 9 fq. 5.**
- Mbi prejardhjen e fjalës *piru* (nga venetishtja perone) shqip: *furkuliçë, cfurk*, te Shqip. e Italisë: *grop*.

571. — ARGUS (Pseudonim): Nje gramatik e ree shqip. — **DIELLI, Boston, Mass. (USA) January 21, 1910, Mot' i parë, vol. I, Nr. 43, fq. 3.**
Recension i shkurtën mbi veprën — «Gramatika shqipe» e për-
bame prej një jezuiti [A. Zanonit?], shtypun në Shyp. Zoja e Papër-
lyeme, Shkodër.
572. — ARGUS (Pseudonim): Nga Shkodra (Korrespondence e Regullshme). — **DIELLI, Boston, Mass. (USA) April 29, 1910, Vit'i dytë, vol. II, Nr. 57, fq. 1-2**
Korrespondencë: 1) kundër Riza beut, një nga autorët dhe për-
krahësit e alfabetit të shqipes me shkronja turke; 2) kundër fut-
jes së shkronjave turke në mësimin e shqipes; 3) mbi fjalorin
italisht-shqip të A. Buzetit (njoftim).
573. — ARNAUD lisani [Gjuha Shqipe]. — **BASHKIM, Stamboll 2 shtator 1910 (1326), Mot'i II, Nr. 34, fq. 2.**
Mbi veprën e Dr. Hahnit, përkthye shqip nga Eqrem Vlora.
574. — ATA që nxjerin sy tek të vënë vetulla. — **LIRIJA, Selanik 6 Shkurt 1910, Mot'i dytë, Nr. 74, fq. 1.**
Artikull kundër përkrahësve të alfabetit të shqipes me shkro-
nja turke. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
575. — ATDHETAR të dashur shqiptarë osmanllinj! — **KORÇA, Korçë 6 Shkurt 1910, Vit'i parë, Nr. 34, fq. 3.**
Thirrje e delegatëve të Kolonjës, Starovës, Oparit, Bilishtit, etj.
mbi mbajtjen (me 14-II-1910) në Korçë të një mitingu të madh të
popullit në shenjë proteste kundër përdorimit të shkronjave arabe
për gjuhën shqipe. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
576. — ĀZAREN (Pseudonim): Alfabeti. Një çeshtje pa funt. — **BASHKIM'I KOMBIT, Manastir 28 Kolozhek 1910, Vit'i I, Nr. 21, fq. 2 (vv).**
Kritikë Kongresit të Manastirit, në të cilin u vendos një alfabet
binjak në vend të një alfabeti të vetëm, tue i lanë shteg sulmeve
të reja nga ana e anmiqvet të kombit, etj.
577. — B.R.: Letra. — **LIRIJA, Selanik 13 Shkurt 1910, Mot'i dytë, Nr. 75, fq. 1-2**
Korrespondencë nga Elbasani: 1) Mitingu n'Elbasan kundër
shkronjavet të huaja; 2) Prap Haxhi Hafëz Sulejman Kungulli me
hafëzet e tij ene Çermenikasit, në të cilët bahet fjalë mbi qëndrimin
pro e kundër alfabetit të shqipes. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
578. — R.B.: Kundërshtarët e shkronjave shqipe ene e verteta. — **LIRIJA Selanik 27 Shkurt 1910, Mot'i dytë, Nr. 77, fq. 1-2.**
Shkruhet se çeshtja e shkronjavet shqipe po zgjidhet përfun-
dimisht në favor të alfabetit latin tue u bashkue me këte alfabet
edhe kundërshtarët e tij. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
579. — BEQIR BASRI: [Letër nga Mitrovica]. — **LIRIJA, Selanik 23 Janar 1910, Mot'i dytë, Nr. 72, fq. 3.**
Lajme: 1) Mbi hapjen në Mitrovicë të një shkollë për mësimin
e gjuhës shqipe; dhe 2) mbi dërgimin nga populli i Mitrovicës
parlamentit dhe qeverisë telegrame proteste kundër shkronjavet
turke. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
580. — BIBLIOGRAFI. — **LIRIJA, Selanik 27 Shkurt 1910, Mot'i dytë, Nr. 77, fq. 3.**
Shënime kritike mbi Bibliografinë Shqype të F. Manek, Dr. G.
Pekmezi, A. Stotz. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

581. — BIBLIOGRAFI: **Shkronjëto e gjuhës shqip**, cop'e parë, radh'e dytë prej N. Lako, me 32 faqe. — **LIRIJA, Selanik 25 Shënëndre 1910, Mot'i tretë, Nr. 108, fq. 3.**
Shënim bibliografik. (Shkrue me alf. e «Stambollit».)
582. — BIBLIOGRAFI: **Koj së dneshnite allbanci i tehnja jazik** (Cilët janë Shqipëtarët e sotëm dhe gjuh'e tyre) — Librë bullgarisht prej Zotit Silian, Shtypurë në Sofje 1910. — **LIRIJA, Selanik 13 Mars 1910, Mot'i dytë, Nr. 79, fq. 3.**
Recension i shkurtën. Në këtë libërth bullgarisht, shkruen recens., autori jep shumë shënime mbi gjuhën shqipe, etimologjinë dhe historinë e saj. Në fund gjëndet një fjalorth shqip, greqisht e latinisht, ku krahasohen fjalët me rranjë të përbashkët. (Shkrue me alf. e «Stambollit».)
583. — BIBLIOGRAFI: «**Shënime per mi shkrimin e vjetrë pellasgisht**» — nga Eqrem Vlora. — **SHQIPETARI, Péra — Cons ple (Turqi) 4 Vjesht e I, 1910, Nr. 30, fq. 2.**
Recension i shkurtën me shënime mbi përmbajtjen e kësaj vepre (libër për abecënë e shqipes).
584. — BIBLIOGRAFIE. — **SHKREPTIMA, Kairo 12/25 Gusht (1910), Vit'i I, Nr. 10, fq. 8.**
1 — **Shkronjëto e gjuhese shqip** — prej N. Lako.
2 — **Njohtime praktike te Gramatikes Shqip** (Régulla e ushtrimé) për Rendin e III-të të shkollës Fillorë — prej Aleksandër Xhuvanit. (Jepet si lajm mbi daljen së shpejti nga shtypi).
585. — BITTËR, GJON: Shtylla literare. — **LIRIJA, Selanik 10 Prill 1910, Mot'i dytë, Nr. 83, fq. 3.**
Diskutim mbi kuptimin dhe prejardhjen e fjalëve **politís, vonë, përshtypje, zyrë, përças, qep**; si dhe parashtesat **për-, në-**. (Shkrue me alf. e «Stambollit».)
586. — CDRI (Pseudonim): «**L'Albanais et l'écriture e sa largue** [Shqipja dhe shkrimi i gjuhës së saj]. — **SHQIPETARI, Péra — Cons/ple (Turqi) 10 Mars 1910, Mot'i II, Nr. 11, Nr. 1.**
Artikull për çeshtje të alfabetit të shqipes. Në caktimin e alfabetit theksohet në këtë artikull, nuk ka të bajë as feja, as politika.
587. — CONGRESSO linguistico Albanese in Italia [Kongres gjuhësor shqiptar në Itali]. — **LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Novembre 1910, Anno XIV, Nr. 21, fq. 5.**
Mbi propozimin e mbajtjes së një kongresi të ri gjuhësor italo-shqiptar në një nga kolonitë arbëneshe në shenjë proteste kundër gjendjes që xhonturqit i krijuene gjuhës shqipe.
588. — CONGRESSO linguistico Albanese in Italia [Kongres gjuhësor Shqiptar në Itali]. — **LA NAZIONE ALBANESE, Pallagario (Catanzaro) Italia, 15 Dicembre 1910, Anno XIV, Nr. 23, fq. 1-2.**
Ribotohet një pjesë nga artikulli i gaz. **Shkreptima**, në lidhje me mbajtjen e një kongresi gjuhësor shqiptar në Itali.
589. — ÇAMI, TOMOR: Alfabeti i ri. — **DIELLI, Boston, Mass. (USA) January 14, 1910, Mot'i pare, vol. I, Nr. 42, fq. 1.**
Letër nga Filati mbi dështimin e përpjekjeve të disa oficerëve xhonturq për të përça shqiptarët tue shpërnda falas abetare shqip me shkronja arabe.

590. — Ç'BËNË? — **KORÇA, Korçë, 22 Janar 1910, Vit'i I-rë, Nr. 31, fq. 1.**
Kryeartikull kundër disa deputetëve, që kërkuen vendosjen e shkronjave turke për gjuhën shqipe. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
591. — Ç'U — BË për shkronjatë shqip. — **LIRIJA, Selanik, 20 Shkurt 1910, Mot'i dytë, Nr. 7, fq. 1.**
Artikull kundër urdhënësës së qeverisë turke, e cila, në kundërshtim me urdhnin e vet të maparshëm, ka urdhënue që në Vilajet të Kosovës gjuha shqipe të mësohet me shkronja arabishte. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
592. — ÇËSTJA e gjuhës Shqipe. — **BASHKIM' I KOMBIT, Manastir 25 Shkurt 1910 (1325), Vit'i I, Nr. 26, fq. 2.**
Ribotohet i përkthym shqip artikulli i Fotios Ntushas, botue greqisht me titullin e sipërm, në fletoren **Neologos tis Anatalis**, Nr. 15, si dhe përgjigja e Emanuil E. Zaharidhi, mbi çeshtjen e alfabetit të shqipes dhe karakteret greke dhe latine të shkronjave.
593. — ÇËSHTJ' e shkronjave shqip. — **LIRIJA, Selanik 9 Janar 1910, Mot'i dytë, Nr. 7, fq. 1.**
Artikull mbi polemikën e hapun në shtypin e Stambollit për çeshtjen e shkronjave (latine e turke) të alfabetit të shqipes. Artikullshkruesi shprehet në favor të alfabetit latin. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
594. — ÇËSHTJ' e shkronjave shqip. — **LIRIJA, Selanik 23 Janar 1910, Mot'i dytë, Nr. 72, fq. 2.**
Simbas gazetës **Sabah** (dt. 18 janar) të Stambollit njoftohet se: 1) nga Elbasani i u dërgue qeverisë një telegram proteste kundër shkronjave turke për gjuhën shqipe; nga Shkupi u dërgue një telegram kundër shkronjave latine për gjuhën shqipe. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
595. — ÇËSHTJ' e Shkronjave shqip dhe shtypi. — **LIRIJA, Selanik 13 Shkurt 1910, Mot'i dytë, Nr. 75, fq. 2**
Jepen lajme nga shtypi turk **Sabah, Tanin e Rumeli** në lidhje me qëndrimin pro e kundër alfabetit të shqipes. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
596. — ÇËSHTJE é Abécése. — **SHQIPETARI, Péra — Cons/ple (Turqi) Shkurt 1910, Mot'i II, Nr. 6, fq. 1-2.**
Artikull në mbrojtje të shkronjave shqipe.
597. — ÇËSHTJE é Shkronjavé. — **SHQIPETARI, Péra — Cons/ple (Turqi), 21 Janar 1910, Mot'i II, Nr. 4, fq. 1.**
Shkruhet se Red. i kanë ardhë protesta nga qytete të ndryshme të Shqipnisë kundër disa deputetve, që kërkojnë shkronjat turke për gjuhën shqipe.
598. — ÇOBA, NDOC: Shkronjat latinishte. — **BASHKIMI, Shkodër 27 Fruer 1910, Vjeta e I, Nr. 9, fq. 1.**
Artikull mbi nevojën e përhapjes së mësimin të gjuhës shqipe dhe spastrimin e saj nga fjalët e hueja; kritikon qëndrimin e disa deputetve, që kërkuene shkronjat turke-arabe; përfundon se alfabeti latin asht ma i përshtatshëm për shqipen.
599. — Ç[OBA], N[DOC]: Germat arabishte. — **BASHKIMI, Shkodër 10 prill 1910, Vjeta e I, Nr. 15, fq. 1-2.**
Artikull kundër qëndrimit fanatik fetar në çeshtjen e alfabetit të shqipes.

600. — DAIÇI (Pseudonim): Prej Durrësit. — **BASHKIM' I KOMBIT**, Manastir 4 Shkurt 1910, Vit'i I, Nr. 22, fq. 2.
Korrespondencë mbi kundërshtimin që prindërit dhe nxanësit e shkollës Idadie të Durrësit i bajnë mësimit të shqipes me shkronja arabe.
601. — DAKO, KRISTO, A.: Cilët janë Shqiptarët. — **TOMORRI**, Elbasan 20 Mars 1910, Vjete I, Nr. 2, fq. 3; Nr. 3, fq. 2-3; Nr. 4, fq. 4; (Nr. 5 mungon); Nr. 6, fq. 4; Nr. 7, fq. 4; Nr. 8, fq. 4 (Nr. 9 mungon); Nr. 10, fq. 4 (vazhdimi ndërpritet).
Studim mbi problemin e origjinës së popullit shqiptar dhe të gjuhës shqipe përmes tezave dhe pikëpamjeve të dijetarëve të huej rreth këtij problemi. (Shih edhe Nr. 482).
602. — DALIA TERRA dei Pelasgi [Nga Dheu i Pellazgëve]. — **LA NAZIONE ALBANESE**, Pallagorio (Catanzaro) Italia 30 Aprile 1910, Anno XIV. Nr. 8, fq. 6-7.
Botohen dy letra, e para pa titull dhe e dyta me titull: **Il popolo Albanese e il suo alfabeto**, nënshkruar nga «Hylli i Shqypnis». Autorët mbajnë qëndrim pro alfabetit latin e kundër alfabetit arab.
603. — DASHAMIRI (Pseudonim): Dyy fjal permii gjuhë shqype. — **BASHKIMI**, Shkoder 20 Fruer 1910, Vjeta I, Nr. 8, fq. 1.
Këshilla mbi nevojën e mësimit të gjuhës shqipe nga rinia.
604. — DEVOLLI (Pseudonim): Çeshtja e Abese. — **FLAMURI**, Boston, Mass. (USA) April 1, 1910, Vol. I, Nr. 7, fq. 1-2.
Korrespondencë nga Korça mbi mbledhjet, mitingjet, etj. që janë mbajtur në Korçë e Manastir pro e kundër alfabetit shqip me shkronja arabe.
605. — DJALI I SHQYPENIS (Pseudonim): Letër prej Dibre. — **SHQYPEJA E SHQYPENIS**, Sofië, më 21 të Shkurtit 1910, Mot'i par, Nr. 18, fq. 2.
Letër mbi një mbledhje të mbajtur në Dibër, nën kryesinë e kryetarit të xhemiletit për heqjen, me urdhën të qeverisë, të shkronjavet latine dhe përdorimin e shkronjavet arabe në gjuhën shqipe si dhe kundërshtimet që sollin në popull kjo masë.
606. — DRANOVIK, V.: Nga Stambolli (Të rat'e këtushme). — **BASHKIM'I KOMBIT**, Manastir 7 Kolozhek 1910, Vit'i I, Nr. 18, fq. 2.
Njoftohet se në shkollën e naltë Mylqie të Stambollit u vu zyrtarisht mësimi i gjuhës shqipe, me mësues Z. Sabri Qytezën.
607. — DY PENDONJËS edhe kritika e një zgjebaraku. — **LIDHJA ORTHODHOKSE**, Korçë 22 Mars 1910, Mot'i parë, Nr. 15, fq. 2.
1. Njoftohet se Arif Hiqmeti, i cili hapi për herë të parë çeshtjen e shkronjavet arabe, në një artikull të botuem në gazetën turke **Sada i Milet** (Nr. 115 dt. 2-III-1910) ka deklaruar se asht pendue dhe heq dorë nga kjo rrugë, tue u zotue se do të përkrähë shkronjat shqipe (alf. latin).
2. Kristo Vasili, kryetar i shoqnisë «Elinizmos», botoi një letër në gazetën greke **Neologos** tue u deklaruar në favor të shkronjavet latine për gjuhën shqipe dhe kundër shkronjavet greke. (Shkruar me alf. e «Stambollit»).
608. — EPIDHAMNIOS (Pseudonim): Shkrimi. — **SHQIPËTARI**, Péra — **Cons/ple (Turqi)** 4 Mars 1910, Mot'i II, Nr. 10, fq. 1.
Autori shkruen kundër artikullit të botuem në gazetën greke **Néa Iméra** të Triestes, nënshkruar nga «Labovitis», në të cilin kërkohet që gjuha shqipe të shkruhet me shkronja greke.

609. — E VERTETA (Pseudonim): Abecete t'ona dhe mbledhje e deputeteve t'ane ne Stamboll. — **DIELLI, Boston, Mass. (USA) March 4, 1910, Vit'i dytë, Vol. II, Nr. 49, fq. 2.**
Kritikë deputetëve përkrahës të alfabetit turk për gjuhën shqipe.
610. — E VERTETA (Pseudonim) Çeshtja e abecese dhe mitinget në Shqipëri. — **DIELLI, Boston Mass. (USA) March 18, 1910, Vit'i dytë, Nr. 51, fq. 1-2 dhe FLAMURI, Boston, Mass. (USA) March 18, 1910, Vol. I, Nr. 5, fq. 1-2.***
Korrespondencë e veçantë mbi çeshtjen e alfabetit të shqipes dhe mbi mitingjet pro e kundra shkronjave turke në Shqipni.
611. — E VERTETA (Pseudonim) Nga një Korrespondence e veçante. — **FLAMURI Boston, Mass. (USA) April 15, 1910, vol. I, Nr. 9, fq. 1-2.**
Lajm mbi mitingun e Korçës dhe të katundeve përreth për mbrojtjen e alfabetit të shqipes me shkronja latine si dhe mbi dergimin në gjyq nga ana e qeverisë të organizatorëve të mitingut.
612. — FITORJA eshte jona. — **BASHKIMI KOMBIT, Manastir 25 Mars 1910, Vit'i I, Nr. 29, fq. 2.**
Artikull mbi vendosmërinë e popullit shqiptar në luftë për mbrojtjen e gjuhës shqipe dhe të alfabetit të saj.
613. — FLOQI, THANAS, V.: Reziku i abesë. — **KORÇA, Korçë 15 Janar 1910, Vit'i I, Nr. 30, fq. 1.**
Thirrje drejtue shqiptarëve që të protestojnë kundër deputetëve, që kërkuenë vendosjen e shkronjave turke për gjuhën shqipe. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
614. — GAZETAT e hueja. — **LIRIJA, Selanik 17 Korrik 1910, Mot'i dytë, Nr. 95, fq. 2.**
Lajm mbi botimin e një kryeartikulli për çeshtjen e alfabetit dhe të gjuhës shqipe, nënshkrue nga P. Ga. në fletoren italiane **Giornale di Sicilia** të Palermos, dt. 15 qershor 1910. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
615. — GAZETËS «Zgjim' i Shqipërisë». — **DIELLI, Boston, Mass. (USA) January 7, 1910, Mot'i pare, vol. I, Nr. 41, fq. 1.**
Përgjigje gaz. **Zgjim' i Shqipërisë** (Nr. 48), në lidhje me botimet ma të herëshme në gjuhën shqipe. Red. shkruen se i pari libër shqip, i njohun deri më sot, asht vepra e Pj. Budit. (Speculum Confessionis, 1621), një egzemplar i të cilit ndodhet në Bib. Naz. të Parisit me Nr. 24, 582.
616. — GHIUHA. — **DIELLI, Sckodra, 25-XII-1910, Mot'i I, Nr. 2, fq. 1-2.**
Artikull i Red. shkruet kundra vendimeve të Kongresit të Manastirit për çeshtjen e alfabetit të shqipes. (Shkrue me alf. e Autorëve të Vjetër të Veriut).
617. — GIUHA. — **BASHKIMI, Shkoder 29 Mai 1910, Vjeta I, Nr. 22, fq. 1.**
Artikull mbi bukurinë dhe lashtësinë e gjuhës shqipe dhe nevojën për t'u punue nga mjeshtrit e gjuhës. A. shkruen se gjuhën e ka damtue edhe prania e dialekteve dhe e nëndialekteve, etj.
618. — GIUHA. — **BASHKIMI, Shkoder 23 Tetuer 1910, Vjeta e I, Nr. 43, fq. 1.**
Artikull kritik kundër tendencave të disave, të cilët emnat e tyne i shkruajnë në gjuhë të hueja, tue tregue përbuzje për shqipen.

*) Nga shkaku se qeveria otomane ndaloi hymjen e **DIELLI-t** në Shqipni, gazeta u botue me dy tituj **DIELLI E FLAMURI** (SH, i A.)

619. — GIUHA Shqype. — **BASHKIMI, Shkoder 9 Kallnuer 1910, Vjeta I, Nr. 2, fq. 1.**
- Kritikë kundër përdorimit në gjuhën shqipe të fjalëve të hueja ose të çpikuna. U bahet thirrje të mblidhen nëpër katunde fjalët thjeshtë shqipe dhe t'i dërgohen kësaj së përkohëshme për botim, të cilat do të vlejné për fjalorin e ri të shqipes.
620. — GJIKA, VANGJEL: Tejshkrim nga Korça. — **LIRIJA, Selanik 20 Shkurt 1910, Mot'i dytë, Nr. 76, fq. 1.**
- Lajm telegrafik mbi mbajtjen e një mitingu të madh nga populli i Korçës kundër shkronjavet arabe (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
621. — GJUHA shqip dhe depytetet. — **LIRIJA, Selanik 9 Janar 1910, Mot'i dytë, Nr. 70, fq. 2.**
- Botohen emnat e disa deputetve, që i kërkuene qeverisë vendosjen e shkronjave turke për gjuhën shqipe. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
622. — GJUHA Shqip dhe depytetë. — **LIRIJA, Selanik 16 Janar 1910, Mot'i dytë, Nr. 71, fq. 1-2.**
- Njoftim mbi botimin në gazetat e Stambollit të një deklarate të nënshkrueme nga 10 deputetë shqiptarë (Ismaji Qemali, Hasan Prishtina, Shahin Kolonja, etj.) në shënjë proteste kundër kërkesës që një grup deputetësh i bani qeverisë për futjen e shkronjave turke në gjuhën shqipe. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
623. — GJUHA shqyp dhe shkronjësit e sajë!... Shih Nr. 523 (1908).
624. — GJUHA shqip në shkollët Mylqije në Stamboll. — **LIRIJA, Selanik 9 Janar 1910, Mot'i dytë, Nr. 70, fq. 1.**
- Njoftim mbi vumjen e mësimit të gjuhës shqipe me mësues Z. Sabri Qyteza në shkollën Mylqije të Stambollit (Shih edhe Nr. 606) (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
625. — GJUHA shqip dhe fetë. — **LIRIJA, Selanik 23 Janar 1910, Mot'i dytë, Nr. 72, fq. 1.**
- Kryeartikull kushtue mbrojtjes së alfabetit të shqipes me shkronja latine. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
626. — GJUHA shqip me shkronjat' e Arapëvet. — **BASHKIM' I KOMBIT, Manastir 21 Kolozhek 1910, Vit'i I, Nr. 20, fq. 1-2.**
- Kritikë deputetëve përkrahës të shkronjave arabe për gjuhën shqipe, dhe argumente në favor të shkronjave latine. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
627. — GJUHA shqip me shkronjat' e Arapëvet. — **BASHKIM' I KOMBIT, Manastir 4 Shkurt 1910, Vit'i I, Nr. 22, fq. 1.**
- Artikull mbi karakterin reaksionar të kërkesës që shqipja të shkruhet me shkronja arabe; vihen në dukje shkaqet që mund të kenë shty autorët e kësaj kërkesë. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
628. — GJUHA shqipe nuk mesohet me shkronja arabishte. — **TOMORRI, Elbasan, 10 Mars 1910, Vjetë I, Nr. 1, fq. 3.**
- Njoftime mbi dorëheqjen në shënjë proteste kundra shkronjave arabe të mësuesit të gjuhës shqipe në Idadie të Elbasanit, Hysein Ceka. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
629. — GLINA, HAKI: Letre e hapur nga Leskoviku. — **BASHKIM' I KOMBIT, Manastir 11 Mars 1910 (1326), Vit'i I, Nr. 27, fq. 2.**

Letër mbi qëndrimin e popullit të Leskovikut në anën e shkronjavet shqipe.

630. — GREVA e nxënësve të idadies (gjimnazios) të Korçës. — **LIDHJA ORTHODHOKSE, Korçë 9 Shkurt 1910, Mot'i parë, Nr. 13, fq. 4.**

Njoftime mbi grevën e nxënësve të gjimnazit të Korçës në shënjë proteste kundër shkronjavet arabe për gjuhën shqipe, dhe mbi përkrahjen nga shokët e tyne të Janinës, Leskovikut, etj. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

631. — H.: Msime përmii giuhë shqype. — **BASHKIMI, Shkoder 2 Tetuer 1910, Vjeta e I, Nr. 40, fq. 1.**

Mbi parashtesat për-, li-; mbi mos zavendësimin e disa turqizlave që kanë hy ç'prej kohësh në shqipet; asht kundër kalkimit të ndër-kombtarizlave (të tipit fotograf, gramofon, etj. në dritëshkrues, za-shkrues, etj.)

632. — H.: Shkrimtarët e huej e gjûha Shqype. — **BASHKIMI, Shkoder 6 Nduer 1910, Vjeta e I, Nr. 45, fq. 1.**

Jepen njoftime të shkurta mbi veprat dhe autorët e huej, që shkruene edhe për gjuhën shqipe si E. Legrand, G. Majer, H. Pedersen, etj.

633. — HIXHARANI, JUSUF: Arnaut gazetasi Midirjetenë [Drejtorisë së gazetës Shqiptari]. — **ARNAUT, Istambul 10-II-1326 1910, Vit'i III, Nr. 51, fq. 2.**

Letër turqisht, me të cilën autori përkrah çeshtjen e alfabetit të shqipes me shkronja latine.

634. — I.M.: Leteratura e giuhës shqype. — **BASHKIMI, Shkoder 8 Mai 1910, Vjeta e I, Nr. 19, fq. 1-2.**

Përmbledhtazi jepet një pasqyrë e veprave që u shkruene në gjuhën shqipe që nga Budi, Bardhi, Bogdani e deri në disa nga autorët bashkëkohas.

635. — INFORMAZIONI Il Congresso Albanese di Monastir [Kongresi Shqiptar i Manastirit]. — **LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia 15 Aprile 1910, Anno XIV, Nr. 7, fq. 7.**

Flitet mbi Kongresin e Manastirit si dhe mbi klubet shqiptare pro alfabetit të shqipes me shkronja latine dhe kundërshtarët e këtij alfabeti.

636. — INFORMAZIONE: Congresso Albanese differito [Kongres Shqiptar i shtym]. — **LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia 15 Luglio 1910, Anno XIV, Nr. 13, fq. 5.**

Mbi shtymjen në një kohë të pacaktueme të kongresit shqiptar që do të mbahej në Janinë për çeshtjen e shkronjavet shqipe.

637. — INFORMAZIONI: Per la lingua albanese [Për gjuhën shqipe]. — **LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia 15 Gennaio 1910, Anno XIV, Nr. 1, fq. 8.**

Njoftohet se në Kalkandelë u themelue një klub shqiptar për mësimin e gjuhës shqipe. Edhe Idadie e Shkupit, tue ndjek shembullim e liceut perandorak të Selanikut, ka çel një kurs të gjuhës shqipe.

638. — KERKIMET qe beri mbledhja e Manastirit. — **BASHKIMI KOMBIT, Manastir 1 Prill 1910 (1326), Vit'i I, Nr. 30, fq. 2.**

Botohen të pesë kërkesat që mbledhja e Manastirit (mbajtun me 20 shkurt 1910) i paraqiti qeverisë në lidhje me çeshtjen e alfabetit të shqipes.

- 639 — KERKIMET te kryengritesve Shqiptare. — **SHQIPËTARI**, Përa-Constantinople (Turqi) 21 dhjetor 1910, Mot'i II, Nr. 43, fq. 2.

Simbas gazetës **Times** të Londrës, mbi dymijë shqiptarë me armë në dorë, nga malet e Dibrës, i bane qeverisë një varg kërkesash (9 pika), në të cilat edhe kërkesa që gjuha shqipe të mësohet me shkronjat kombëtare (alf. latin). (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

640. — **KËLUP** Seddi [Mbyllja e Klubit]. — **BASHKIM**, Stamboll 5.X.1326/1910/Mot'i II, Nr. 39, fq. 2.

Lajm mbi mbylljen e Klubit shqiptar dhe të shkollave shqipe në kazanë (qytetin) e Koçanës (Maqedoni) nga autoritetet turke si dhe mbi protestën e popullsisë së vendit drejtue ministrisë së mbrendëshme (Shkrue turqisht).

641. — **KONGRESI** Shqyptarë ne Monastir. — **BASHKIMI**, Shkoder 17 Prill 1910, Vjeta e I, Nr. 10, fq. 4.

Njoftime mbi hapjen me 2 prill 1910 të Kongresit të Manastirit si dhe mbi pjesëmarrësit në këtë kongres.

642. — [KONICA, FAIK]: Nota letrare. — **DIELLI**, Boston, Mass. (USA) March 18, 1910, Vit'i dyte, vol. II, Nr. 51, fq. 3 dhe **FLAMURI**, Boston, Mass. (USA) March 18, 1910, vol. I, Nr. 5, fq. 2-3.

Ndër të tjera jepen edhe këto shënime bibliografike: 1. Ing. F. Manek, Dr. G. Pekmezi, Ob. Leut. A. Stotz: **Albanesische Bibliographie** (Bibliographia Shqype), 147 ff., in-8, Vienë, 1909.

2. At Anton M. Xanoni, S. J. **Gramatika shqyp**, 174 ff., in-4 të vogël, Shkoder 1909.

U bahet edhe nga një shënim i shkurtër kritik.

643. — **KOMANI I KRISHTERE** (Pseudonim): Gjuha Shqipe në Universitetet t'Athines. — **BASHKIM I KOMBIT**, Manastir 3 Qershor 1910 (1326), Vit'i I, Nr. 39, fq. 1.

Njoftim mbi çeljen së afërmi të një katedre të gjuhës shqipe në Universitet të Athinës.

644. — **KRASTA** (Pseudonim): Korrespondencë e regullshme na Elbasani. — **KORÇA**, Korçë 16 Mars 1910, Vit'i II, Nr. 1 (37), fq. 2.

Mbi kërkesën e komisarit të policisë dhe mutesarifit (prefektit) të Elbasanit ba drejtorisë së shkollës Idadie që të futet mësimi i shqipes me alfabetin arabisht. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

645. — **KRASTA** (Pseudonim): Çashtja e alfabetit n'Elbasan. — **KORÇA**, Korçë 12 Shkurt 1910, Vit'i I-rë, Nr. 34, fq. 1-2.

Shkruhet 1) kundër një deputeti të Elbasanit, i cili kërkoi në Stamboll shkronjat arabe për gjuhën shqipe; 2) mbi përgatitjen e një mitingu të madh në Elbasan për të protestue Shkronjat arabe si dhe 3) mbi protestën e nxanësve të shkollës Idadie kundër futjes së shkronjave arabe në mësimin e shqipes. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

646. — **KULLA E Babelit**. — **BASHKIMI**, Shkoder 15 Mai 1910, Vjeta e I, Nr. 20 fq. 1.

Artikull mbi damet dhe vështirësitë që i ka sjell bashkimit të gjuhës shqipe prania e alfabeve të ndryshme.

647. — L.G.: Shkronjat shqype edhe Shqiptarët e jashtëmë. — **TOMORRI**, Elbasan 10 Mars 1910, Vjetë I, Nr. 1, fq. 3.

Njoftime të nxjerra nga gazeta **La Turquie** e Stambollit, mbi organizimin e mitingjeve nga Shqiptarët e Amerikës dhe të Rumanisë për mbrojtjen e shkronjavet shqipe kundër shkronjavet arabe.

648. — L'ALPHABET Albanais [Alfabeti Shqip]. — **SHQIPETARI**, Péra — **Cons/ple (Turqi) 18 Shkurt 1910, Mot'i II, Nr. 8, fq. 1-2.**

Botohen telegrame dhe letra të ardhuna nga Elbasani, Shkodra, Korça, Bukureshti, Konstanca, etj. në të cilat shprehet protesta dhe zemërimi i shqiptarëve të mbledhur në mitingje kundër disa deputetëve, që kërkojnë të fusin shkronjat arabo-turke në gjuhën shqipe.

649. — L'ALPHABET Albanais [Alfabeti Shqip]. — **SHQIPETARI**, Péra — **Cons/ple (Turqi) 25 Shkurt 1910, Mot'i II, Nr. 9, fq. 1.**

Artikull nxjerrë nga **Osmanischer Lloyd** e Stambollit, shkruar në mbrojtje të alfabetit shqip.

650. — LA QUESTION de l'alphabet albanais. Déclarations de Myfid bey [Çesh-tja e alfabetit shqip. Deklaratat e Myfid beut]. — **SHQIPETARI**, Péra — **Cons/ple (Turqi) Shkurt 1910, Mot'i II, Nr. 6, fq. 1.**

Intervistë dhanë gazetës **Osmanischer Lloyd**, në të cilën autori mban qëndrim në favor të alfabetit latin për shkronjat shqipe dhe kundër alfabetit arab. (Këtu botohen edhe emnat e deputetëve, të cilët propozuen shkronjat arabe).

651. — **L'À SCURITTURA** albanese e i suoi avversari [Shkrimi shqip dhe kundër-shtarët e tij]. — **LA NAZIONE ALBANESE**, Pallagorio (Catanzaro) **Italia 15 Febbraio 1910, Anno XIV, Nr. 3, fq. 3-6.**

Botohet i përkthyer në italisht artikulli i Filip Noggës, botue në gaz. **La Turquie** të Stambollit. (Shih edhe Nr. 724). Ribotohen edhe fragmente nga shtypi i kohës (**Jeni Gazeta, Journal de Salonique, Lirija, Albanais, La Turquie**) në të cilat shprehet kundërshtimi për shkronjat arabe.

652. — [LAJMJ]. — **BASHKIMI**, Shkoder 20 Fruer 1910, Vjeta I, Nr. 8, fq. 1.

Mbi telegramet ardhun redaksisë nga Elbasani, Tirana, Leskoviku e Preveza, në të cilat shprehet protesta kundër deputetëve, që kërkuene shkronjat me alfabetin turk.

653. — LAJME nga shtypi i huaj. — **ZGJIM' I SHQIPËRISE**, Janinë 29 Mars 1910, **Mot'i I, Nr. 74, fq. 2.**

Njoftim mbi botimin e një artikulli nga Z. Çako rreth çështjes së shkronjavet shqipe në gaz. **The Levant Herald** (dt. 30 mars 1910). Mbi këtë argument shkruen edhe gazeta turke **Tesviri Efkar**. (Shkruar me alf. e «Stambollit»).

654. — LAJME édhë te tjëra. — **SHKREPTIMA**, Kairo 12/25 Shendre (1910), **Vi'i I, Nr. 13, fq. 8.**

Tue komentue daljen e revistës **Glasul Albanieci** në Bukuresht, shkurt jepen edhe disa shënime të marrëdhajeve gjuhësore shqiptaro-rumune (influenca hipotetike e a rumune në ë e toskënishtes).

655. — LAJMET e javes: Shtypi Shqyp. — **BASHKIMI**, Shkoder 13 Mars 1910, **Vjeta I, Nr. 11, fq. 3-4.**

Lajme:

1. Mbi një telegram proteste ba nga krahina e Konicës ministrit turk kundër shkronjavet arabe për shqipen;

2. Mbi braktisjen e shkollës nga nxanësit e Mejtepit Ruzhdije të Korçës në shenjë proteste kundër vendimit të drejtorisë për futjen e shkronjave arabe në mësimin e shqipes;
3. Mbi mbajtjen në Berat të një mitingu të madh prej 15.000 vetash për mbrojtjen e shkronjave shqipe;
4. Mbi mbledhjen së shpejti të delegatëve të të gjitha klubeve të Shqipërisë në klubin qendror të Manastirit për të bisedue mbi çështjen e alfabetit të shqipes;
5. Mbi kërkesën e studentëve shqiptarë universitarë, që studjojnë në Turqi, paraqitë Vezirit që të lejohet shkrimi i gjuhës shqipe me alfabetin latin e jo arab.

656. — LAJMET E Javës. — **BASHKIMI, Shkoder 22 Mai 1910, Vjeta e I, Nr. 21, fq. 4.**

Mbi futjen e mësimin të gjuhës shqipe në shkollën Idadie të Selanikut.

657. — LAJMET E Javës: Marrim prej fletores «Lirija» me 19 t'Qershorit. — **BASHKIMI, Shkoder 17 Korrik 1910, Vjeta e I, Nr. 29, fq. 3.**

Mbi çeljen në Shkodër të një dege të klubit të alfabetit të shqipes me shkronja arabe me pjesëmarrjen e ushtarakëve dhe të disa qytetarëve. Red. në një shënim të sajn fton gjithë shqiptarët të mos marrin pjesë në këtë klub.

658. — LAJMET E Javës: Alfabeti Shqyp. — **BASHKIMI, Shkoder 18 Dhetuer 1910, Vjeta e I, Nr. 51, fq. 3.**

Simbas gazetës **Le Moniteur Oriental**, bahet e ditun se asht lejue çelja e shkollave shqipe dhe mësimi i gjuhës me alfabetin latin.

659. — LAJMET E Javës: Austria e gjuha shqype. — **BASHKIMI, Shkodër 25 Dhetuer 1910, Vjeta e I, Nr. 52, fq. 4.**

Simbas fletores **Le Moniteur Oriental**, qeveria austriake do të çelë në Vjenë një shkollë për mësimin e gjuhës shqipe.

660. — LAJMET e vendit. — **KORÇA, Korçë 30 Janar 1910, Vit'i I, Nr. 32, fq. 3.**

Lajme e telegrame të ardhuna nga vise të ndryshme të Shqipërisë kundër futjes së shkronjave arabe në gjuhën shqipe dhe njoftime të tjera pro e kundër alfabetit shqip. (Shkrue me alf. e «Stambollit».)

661. — LAJMET e të rat e vendit. — **LIDHJA ORTHODHOKSE, Korçë 14 Prill 1910, Mot'i parë, Nr. 17, fq. 3.**

Lajme:

1. Gazeta ruse **Ruski Silovo** (Nr. 67, dt. 23 mars) shkruen një artikull të gjatë mbi Kongresin e Manastirit.
2. Njoftohet se në Universitetin e Athinës do të vihet së shpejti mësimi i shqipes dhe se do të botohet në atë qytet një gazetë shqip e greqisht. (Shkrue me alf. e «Stambollit».)

662. — LAMOUCHE, L.: Gjuha shqip. — **KALENDARI KOMBIAR, Selanik 1910, Mot'i katër-mbëdhjetë, fq. 42-49.**

Artikull mbi lashtësinë dhe origjinën e gjuhës shqipe dhe qëndrimet e dijetarëve të ndryshëm ndaj problemit të shqipes. Autori mbron tezën që gjuha shqipe asht një gjuhë indoeuropiane; shkruen për afrinë gjuhësore shqiptaro-rumune, për prioritetin e huazimeve latine në gjuhën shqipe, etj. Në fund Red. e **KALENDARIT** jep një informatë të shkurtën mbi artikullshkruesin. (Shkrue me alf. e «Stambollit».)

663. — L'ECRITURE Albanaise [Shkrimi shqip]. **SHQIPETARI**, Péra-Cons/ple (Turqi) 28 Janar 1910, Mot'i II, Nr. 5, fq. 1.
Ribotohet artikulli i Dr. Shreder (Schraeder) botue në *L'Osmanser Lloyd* për çeshtjen e alfabetit të shqipes. Shreder shkruen se alfabeti semitik, siç asht alfabeti arabo-turk, shkencërisht nuk mund të aplkohet për asnjë gjuhë ariane, pra as për gjuhën shqipe. Ai asht për alfabetin latin.
664. — LETËR e hapur kundrështarëve të abesë kombëtare. — **KORÇA, Korçë**, 16 Mars 1910, Vit'i II, Nr. 1 (37), fq. 1.
Thirrje përkrahësve të alfabetit arab të heqin dorë nga kjo tradhëti e të bashkohen për alfabetin shqip. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
665. — LETRË (Korrespondencë nga Shkupi). — **LIRIJA**, Selanik 30 Janar 1910, Mot'i dytë, Nr. 73, fq. 1-2.
Njoftime mbi mitingun e Shkupit pro shkronjave turke. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
666. — LETRË nga Shoqëria «Bashkim» në Bukuresht Depytenjvet Shqipëtarë, — **BASHKIM' I KOMBIT**, Manastir 18 Shkurt 1910 (1325), Vit'i I, Nr. 24, fq. 3.
Letër e Pleqësisë së Shoq. Shqiptare «Bashkimi» të Bukureshtit, me anën e të cilës njoftohet se të gjithë anëtarët e shoqnisë bashkohen me mbrojtësit e alfabetit të shqipes.
667. — LETRË nga Bukureshti. — **LIRIJA**, Selanik 20 Shkurt 1910, Mot'i dytë, Nr. 71, fq. 2.
Shoq. «Bashkimi» e Bukureshtit bashkohet me protestat e shqiptarve kundër deputetve që kërkojnë vendosjen e shkronjave arabe për gjuhën shqipe. (Shkrue me alf. e Stambollit).
668. — LETRË nga Prespa. — **BASHKIM' I KOMBIT**, Manastir 1 Prill 1910 (1325), Vit'i I, Nr. 30, fq. 1.
Letër mbi kërcënimet e frikësimet që autoritetet e Prespës janë tue ba kundër popullit, me të cilat duen ta detyrojnë atë të pranojë alfabetin arab për gjuhën shqipe. Populli, përfundon letra, asht për alfabetin kombëtar (latin). (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
669. — LETRË nga Buenos Aires. — **LIRIJA**, Selanik 8 Maj 1910, Mot'i dytë, Nr. 87, fq. 2.
Njoftime mbi protestimet e Shqiptarëve të qytetit Tolosa, Buenos Aires (Argjentinë) kundra shkronjavet arabe për gjuhën shqipe. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
670. — LEVIZEJA dhe të reat e Saja. — **SHQYPEJA E SHQYPËNIS**, Sofië më 6 të Shkurtit 1910, Mot'i par, Nr. 17, fq. 4.
Lajme: 1) Mitingu kundra shkronjave shqyp në Manastir dhe qëndrimi protestues i Red. ndaj këtij mitingu dhe 2) Pendimi i myftiut Monastirit, ku thuhet se autori i abetarit shqip me shkronja arabe, asht pendue botnisht dhe pranon gabimin që ka ba tue përdorë alfabetin arab.
671. — LEVIZEJA dhe të reat e Saja. — **SHQYPEJA E SHQYPËNIS**, Sofië, më 21 të Shkurtit 1910, Mot'i par, Nr. 18, fq. 3.
Lajme: 1) Dy mitinge në Elbasan, i pari, ma i vogël, pro dhe i dyti, i madh, kundra shkronjave arabe për gjuhën shqipe; 2) Killubi i shqypëtarvet në Jonin msojtore kombëtare, ku thuhet se nxañësit e Idadies së Janinës, për shkak se iu imponue mësimi i shqipes me

shkronja arabe, e braktisën shkollën dhe u grumbulluen në klubin e shqiptarëve për të mësue vetëm gjuhën amtare.

672. — LEVIZJA dhe të reat e Saja. — **SHQYPEJA E SHQYPËNIS**, Sofië më 11 të Marsit 1910, **Mot'i par**, Nr. 19, fq. 4.

Mbi veprimin e qeverisë otomane, e cila, në kundërshtim me kushtetutën dhe kundër dëshirave të shprehuna në mitingjet popullore, ka urdhënue të përdoren për gjuhën shqipe vetëm shkronjat arabe. Lajme nga Filati, Berati, Konica, Kosova e Shkodra mbi mitingjet e protestat e bame kundër shkronjave arabe.

673. — LIBOHOVA, N.Q.: Nevojat shkollare. — **LIRIJA**, Selanik 4 Shënëndre 1910, **Mot'i tretë**, Nr. 105, fq. 1.

Njoftim mbi përgatitjen nga S. Kolea të një fjalori prej 60-70 mijë fjalësh, i cili pritet të shtypet së shpejti. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

674. — LIBRA «Gabim Dllirësia» — Gjuk Dukagjini! — **LIRIJA**, Selanik 13 Vjeshtë e tretë, 1910, **Mot'i tretë**, Nr. 103, fq. 2.

Informacion bibliografik mbi daljen e «Gramer Theorik» turqisht-shqip, faqe 212, e Gjuk Dukagjinit, shtypun në Manastir më 1910. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

675. — LIRIDASHËSI (Pseudonim): Puna e shkronjavet. (Korrespondencë e rregullshme nga Stambolli). — **FLAMURI**, Boston, Mass. (USA) February 18, 1910, Vol. I, Nr. 1, fq. 2.

Lajme mbi qëndrimin e deputetëve shqiptarë në Stamboll pro e kundër alfabetit shqip.

676. — LIRIDASHËSI (Pseudonim): Protestot. — **DIELLI**, Boston, Mass. (USA) March 4, 1910, **Vit'i dyte**, vol. II, Nr. 49, fq. 3.

Lajme nga Elbasani, Preveza, Ohri e Tirana për protestimet kundër përdorimit të shkronjave turke në gjuhën shqipe.

677. — LIRIDASHËSI (Pseudonim) U-be fare rezil. Protestat për shkrimin arabisht. (Korrespondencë e rregullshme nga Stambolli). — **DIELLI**, Boston, Mass. (USA) March 11, 1910, **Vit'i dytë**, vol. II, Nr. 50, fq. 1. dhe **FLAMURI**, Boston, Mass. (USA) March 11, 1910, vol. I, Nr. 4, fq. 1.

Artikull mbi demaskimin e veprimtarisë së qeverisë turke, e cila msheftazi ndihmon përkrahësit e shkronjavet arabe për gjuhën shqipe dhe mbi mitingun e Elbasanit në shenjë proteste kundra shkronjavet arabe.

678. — LIRIDASHËSI (Pseudonim): Meseleja e harfeve në Shqiperi (Korrespondence e rregullshme nga Stambolli). — **FLAMURI**, Boston, Mass. (USA) April 1, 1910, vol. I, Nr. 7, fq. 2.

Artikull mbi mitingjet e protestat e bame në një varg qytetesh të Shqipnisë (Elbasan, Korçë, Përmet, Leskovik, Berat, Gramsh, Filat, Gjirokastrë, Prevezë e Janinë) kundër dy mitingjeve të rreme që u mbajtën në Manastir e Shkup, nën nxitjen e xhonturqe, për shkronjat arabe. Në fund njoftohet se në Stamboll u çel një klub për propagandimin e shkronjave arabe.

679. — LIRIDASHËSI (Pseudonim) TRIOFM (Korrespondencë e rregullshme nga Stambolli). — **FLAMURI**, Boston, Mass. (USA) April 15, 1910, vol. I, Nr. 9, fq. 1.

Mbi artikullin e Arif Hiqmetit, botue në gazetën **Sadaj Milet**, në të cilin A.H. hedh poshtë gjithë shkrimet dhe përpjekjet e tija për shkro-

njat arabe, tue deklarue se do të jetë anëtar i shkrimit kombëtar (alfabetit latin).

680. — LIRIJASË (Pseud. i **Hil Mosit**) Leter prej Korçë. — **SHQIPETARI, Péra — Cons/ple (Turqi) 11 Shkurt 1910, Mot'i II, Nr. 7, fq. 1-2.**

Artikull mbi një mbledhje që u mbajt në Korçë, nën kryesinë e Myderrizit, për të protestue kundra shkronjavet shqipe dhe zemërimin që shkaktoi në popull kjo mbledhje.

681. — LIRIJASË (Pseud. i **Hil Mosit**): Leter prej Korçë. — **SHQIPETARI, Péra — Cons/ple (Turqi) 25 Shkurt 1910, Mot'i II, Nr. 9, fq. 1-2.**

Jepen njoftime mbi mbledhjen e mbajtur nën kryesinë e myderrizit të Korçës për të kundërshtue shkronjat shqipe dhe mbi mitingun e madh prej 10.000 vetash që u mbajt për mbrojtjen e shkronjave shqipe kundër alfabetit arab.

682. — LOGORAJ, A.: Kundërshtim a vdekje (Nga Vlora). — **DIELLI, Boston, Mass. (USA) April 29, 1910, Vit'i dyte, vsl. II, Nr. 57, fq. 1-2.**

Korrespondencë kundër alfabetit me shkronja turke.

683. — LORECCHIO, ANSELMO: La Scrittura albanese [Shkrimi shqip.] — **LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 29 Febbraio 1910, Anno XIV, Nr. 4, fq. 1-2.**

Artikull i mbështetur në lajmet e gaz. **La Turquie** në të cilën thuhet se disa ulema shqiptare kanë adoptue shkronjat arabe për gjuhën shqipe, etj. Botohet edhe një letër e Klubit të Follorinës mbi mospajtimin e këtij klubi me thirrjen e Myftiut të Follorinës për të shkruar shqipen me shkronja arabe etj. Mbi këtë argument botohen edhe disa lajme marrë nga gazeta **Journal de Selanique**.

684. — LORECCHIO, ANSELMO: La lingua albanese ed i caratteri arabi [Gjuha shqipe dhe shkronjat arabe]. — **LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia 15 Marzo 1910, Anno XIV, Nr. 5 fq. 1-2.**

Riprodhohen (të përkthyer në italisht) dy artikuj të botuem në **Journal de Salonique** (dt. 4 e 8 mars 1910) të nënshkruem nga «Albanofil», në të cilat kritikohen ashpër përkrahësit e alfabetit shqip me shkronja arabe. Po këtu botohet edhe një letër e Albert Gjikkës drejtue Vezirit të Madh si protestë kundër futjes së shkronjave arabe në gjuhën shqipe.

685. — LORECCHIO, ANSELMO: Antichità della lingua albanese. Alfabeto unico albanese. Necessità di un altro Congresso linguistico tra gli albanesi d'Italia [Lashtesia e gjuhës shqipe. Alfabeti i përbashkët shqiptar. Nevoja për një tjetër Kongres gjuhësor në mes të shqiptarëve të Italisë]. — **LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia 15 Novembre 1910, Anno XIV, Nr. 21, fq. 1-2.**

Jepen citate nga De Rada, Ksilanderi, G. Majeri, C. Kantu, etj. të cilat sillen si provë e lashtësisë së gjuhës shqipe, që A. i paraqet si kundërpeshë ndaj mohimit që xhonturqit po i bajnë gjuhës shqipe e popullit shqiptar. Në fund propozohet thirrja e një kongresi tjetër gjuhësor për të provue se në mes të kongreseve të maparëshme arbëneshe dhe Kongresit të Manastirit nuk ka mosmarrëveshje.

686. — LUMI VIOSA (Pseudonim) Mitingu në Korçë. — **LIRIJA, Selanik 20 Shkurt 1910, Mot'i dytë, Nr. 76, fq. 1.**

Korrespondencë mbi mitingun e madh të Korçës dhe të katundeve përreth (Kolonjë, Starovë, Devoll, Fushë e Korçës, Opar, etj.) në shënjë proteste kundra shkronjave arabe. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

687. — M.: Nga Monastiri. — **FLAMURI, Boston, Mass. (USA) March 11, 1910, vol. I Nr. 4, fq. 2-3.**

Letër mbi një miting të mbajtur në xhaminë «Izaqie» të Manastirit, në të cilin Niazi beu foli se shqiptarët duhet të shkruajnë me shkronja arabe.

688. — M.D.: Letrë nga Filati. — **FLAMURI, Boston, Mass. (USA) April 1, 1910, Vol. I, Nr. 7, fq. 4.**

Letër mbi një mbledhje që u mbajt në medresenë e fshatit, në të cilën myderrizi foli kundër shkronjave të gjuhës shqipe dhe kundërshtimin që ndeshi në popull fjala e myderrizit.

689. — MAL' I BARDHE (Pseudonim): Letrë nga Shpati. — **BASHKIM' I KOMBIT, Manastir 4 Shkurt 1910, Vit'i I, Nr. 22, fq. 2.**

Letër në mbrojtje të alfabetit të shqipes me shkronja latine. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

690. — MARRIM preje **Bashkimi i Kombit Nr. 21.** — **BASHKIMI, Shkoder 20 Fruer 1910, Vjeta e I, Nr. 8, fq. 1.**

Lajm në favor të shkronjave latine.

691. — **MBLEDHJA** për abenë Shqipe në Korçë. — **KORÇA, Korçë 18 Shkurt 1910, Vit'i I, Nr. 35, fq. 1-2.**

Kryeartikull kushtue mitingut të madh të Korçës në mbrojtje të alfabetit të shqipes. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

692. — **MBLEDHJ'** e Shqipëtarëve në Manastir. — **BASHKIM' I KOMBIT, Manastir 25 Mars 1910 (1326), Vit'i I, Nr. 29, faqe 1-2.**

Pasqyrë e punimeve të kësaj mbledhjeje, emnat e përfaqësuesve të 35 viseve të ndryshme të Shqipërisë, fjalimet që u mbajtën në këtë mbledhje në favor të alfabetit të shqipes me shkronja latine, etj. Botohet edhe vendimi (prej 10 nenesh) që u aprovue në këtë mbledhje.

693. — **MBLEDHJA** e Shqipëtarëve në Manastir. — **TOMORRI, Elbasan 31 Mars 1910, Vjeta e I, Nr. 3, fq. 4.**

Botohen vendimet dhe kërkesat që u bane në mbledhjen e Manastirit.

694. — **MEMORIALE** del Congresso Albanese di Monastir alla Sublime Porta [Përkujtesë e Kongresit Shqiptar të Manastirit Portës së Naltë (qeverisë turke)]. — **LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia 15 Maggio 1910, Anno XIV, Nr. 9, fq. 8.**

Botohet deklarata e Mbledhjes së Manastirit (mbajtur me 20 Mars 1910) drejtue qeverisë turke në lidhje me çështjen e shkronjave të alfabetit të shqipes.

695. — **METINGU** i shkronjave shqip. — **LIDHJA ORTHODHOKSE, Korçë 22 Shkurt 1910, Mot'i parë, Nr. 14, fq. 1-2.**

Kronikë mbi mitingun e madh të Korçës (mbajtur me 14 Shkurt 1910) për të mbrojtur alfabetin e shqipes me shkronja latine. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

696. — **MIKU I SHQYPNIIS** (Pseudonim): Gjuha shqype. — **BASHKIMI, Shkoder 13 Fruer 1910, Vjeta e I, Nr. 7, fq. 2-3.**

Botohen informata të nxjerrë nga shtypi i kohës në lidhje me qëndrimin e disa deputetëve pro e kundra alfabetit shqip me shkronja latine.

697. — **MINISTRI** i diturisë dhe shkronjat e Arapëvet. — **BASHKIM'I KOMBIT, Manastir 4 Mars 1910 (1326), Vit'i I, Nr. 26, fq. 1.**

Artikull kritik kundër qëndrimit të ministrit turk të arësimit, i cili, në kundërshtim me dëshirën dhe kërkesën e popullit shqiptar, ka urdhënue futjen e shkronjave arabe për gjuhën shqipe.

698. — **MITINGU** në Manastir kundër shkronjavet shqip (!!!). — **BASHKIM'I KOMBIT Manastir 28 Kollozhek 1910, Vit'i I, Nr. 21, fq. 1.**

Kryeartikull shkruie kundra mitingut të organizuem në Manastir për shkronjat arabe.

699. — **MITINGU** ndë Ysqyp. — **BASHKIM'I KOMBIT, Manastir 28 Kollozhek 1910, Vit'i I, Nr. 21, fq. 1.**

Artikull kundër mitingut që u mbajt në Shkup me 21 dhjetor 1909, i organizuem me përkrahjen e qeverisë, për të kërkuie shkronjat arabe për gjuhën shqipe. Lajme pro alfabetit arab jepen edhe nga Korça e Sallahona.

700. — **MOSI, HIL: Moti 1910. — SHQIPETARI, Péra — Constantinople (Turqi) 25 Dhjetor 1910, Mot'i II, Nr. 44, fq. 1 dhe 5 Kallnor 1911, Mot'i III, Nr. 45, fq. 1.**

Pasqyrë e ngjarjevet kryesore të vjetit 1910 mbi qëndrimin pro e kundër alfabetit të shqipes me shkronja latine në vise të ndryshme të Shqipnisë dhe në kolonitë shqiptare jashtë. (Shkruie me alf. e «Stambollit»).

701. — **N.B.: Letër nga Filati (Korrespondencë e rregullshme). — KORÇA, Korçë 16 Mars 1910, Vit'i II, Nr. 1, fq. 2.**

Shkruhet se i gjithë populli i Filatit asht me abenë kombëtare (me alf. latin), kundra asht vetëm myderrizi me nxanësit e tij.

702. — **NABUKODONOSORI (Pseudonim): Andërra t'pame n'Shkoder. — BASHKIMI, Shkoder 6 Marc 1910, Vjeta e I, Nr. 10, fq. 2-3; Nr. 11, fq. 2:**

Me një kritikë sarkastike A. godet gjithë ata shqiptarë që mohojnë nevojën e mësimt të gjuhës shqipe, tue pëlqye gjuhët e hueja.

703. — **NDJEKJE** kundër mitingut të Korçësë. — **LIRIJA, Selanik 10 Prill 1910, Mot'i dytë, Nr. 83, fq. 2.**

Artikull mbi ndjekjet që qeveria otomane asht tue ba kundër organizatorëve të mitingut të mbajtur në Korçë për mbrojtjen e alfabetit të shqipes (Shkruie me alf. e «Stambollit»).

704. — **NE KLUB** të Selanikut. — **LIRIJA, Selanik 20 Mars 1910, Mot'i dytë, Nr. 80, fq. 30.**

Lajm mbi konferencën që u mbajt në Klubin shqiptar të Selanikut për historinë e shkrimit shqip nga Mehdi Frashëri. (Shkruie me alf. e «Stambollit»).

705. — **NE STAMBOLL.** — **LIRIJA, Selanik 23 Janar 1910, Mot'i dytë, Nr. 72, fq. 1-2.**

Artikull mbi mbledhjen që mbajtën anëtarët e shkrimit shqip në Klubin shqiptar të Stambollit, ku u diskutue çeshtja e mbrojtjes së alfabetit të shqipes (me shkronja latine). Në këtë mbledhje

muerën pjesë edhe disa nga ish përkrahësit e shkronjave turke. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

706. — NE Stamboll. — **LIRIJA, Selanik 6 Mars 1910, Mot' dytë, Nr. 78, fq. 1.**

— Lajme: mbi kërkesën e shoqnisë së studentëve universitarë të Stambollit, e formueme për lulëzim të gjuhës shqipe, që të njihet zyrtarisht nga qeveria;

— Mbi një konferencë të mbajtur në Klubin e Shqiptarëve të Stambollit, nga Riza Tefik beu, i cili u deklarue përkrahës i alfabetit latin e kundër alfabetit arab për gjuhën shqipe. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

707. — NE Shkup. — **LIRIJA, Selanik 2 Janar 1910, Mot'i II, Nr. 69, fq. 2.**

Lajme mbi themelimin në Shkup të «Shoqërisë për të përhapurë mësimin e gjuhës shqip me shkronja turqisht». Ma poshtë thuhet se Klubi i Shqipëtarëve në Shkup shoqininë e naltpërmendun e paditi në gjyq si një shoqni përçamëse. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

708. — NGA Klub'i Selanikut. — **LIRIJA, Selanik 2 Janar 1910, Mot'i dytë, Nr. 69, fq. 2.**

Njoftohet se në Klubin e Selanikut veç turqishtes e frangjishtes, jepet çdo ditë edhe mësimi i gjuhës shqipe. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

709. — NGA Stamboll. — **LIRIJA, Selanik 16 Janar 1910, Mot'i dytë, Nr. 71, fq. 2.**

Lajme mbi manifestimin e studentëve shqiptarë të Stambollit para shtypshkronjës së gaz. **Tanin** në shënjë falnderimi për artikujt e shkruem në favor të shkronjavet shqipe. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

710. — NGA Shqiperia. — **SHQIPETARI, Përa — Cons/ple (Turqi) 11 Shkurt 1910, Mot'i II, Nr. 7, fq. 1.**

Lajme mbi mitingun e Elbasanit në mbrojtje të shkronjave shqipe.

711. — NGA Shqipëria. — **SHQIPETARI, Përa — Cons/ple (Turqi) 4 Mars 1910, Mot'i II, Nr. 10, fq. 1-2.**

Lajme mbi disa telegrame proteste nga populli i Beratit, Gramshit, Delvinës e Filatit ba qeverisë kundër futjes së shkronjave arabo-turke në gjuhën shqipe.

712. — NGAJATE për të cilatë larotë na dorëzojnë shkronjat e Arapëvet. — **BASHKIM'I KOMBIT, Manastir 11 Mars 1910 (1326), Vit'i I, Nr. 27, fq. 1.**

Artikull mbi shkaqet që i shtynë disa njerëz t'i impononin shqipes shkronjat arabe, etj.

713. — NGJARJET e motit 1910. — **KALENDARI «KORÇA» për motin 1911, Manastir 1910, Mot'i dytë, fq. 17-19.**

Pasqyrë përmbledhëse e ngjarjeve kryesore që ndodhën në Shqipni lidhun me çeshtjen e alfabetit të shqipes (pro dhe kundër shkronjave latine). (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

714. — NIVICA, S.: Shkronjat e gjuhës Shqipe dhe mendimet e përgjithëshme. — **BASHKIM'I KOMBIT, Manastir 4 Shkurt 1910 (1326), Vit'i I, Nr. 26, fq. 2.**

Artikull mbi zhurmën që u krijue rreth çeshtjes së alfabetit të shqipes etj. dhe jehona pozitive që pati në popull se gjuha shqipe s'ka lidhje me fenë.

715. — «Një luftë Abecerash». — **FLAMURI, Boston, Mass. (USA) March 18, 1910, vol. I, Nr. 5, fq. 3.**

Lajm mbi një kryeartikull të botuem në gaz. **The Sun** të Nju Jorkut për alfabetin shqip me titullin e sipërm. Botohet edhe një përmbledhje e shkurtën e këtij artikulli.

716. — **NJË ARBËRESH TË SICILIES** (Pseudonim): Letrë nga Italia. — **LIRIJA, Selanik 19 Qershor 1910, Mot'i dytë, Nr. 92, fq. 3.**

Artikull kundër shkronjave arabe për gjuhën shqipe. Si provë të lashtësisë së alfabetit latin për gjuhën shqipe, A. sjell një copë nga «Meshari» i Gjon Buzukut (1555) të kthym edhe në versionin e shqipes së sotme. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

717. — **NJE FSHATARAK PERMETAS** (Pseudonim) Abeceja Shqipe. Lajthimet e Kongresit të Manastirit dhe intrigat e Xhon-Dudume. — **FLAMURI, Boston, Mass. (USA) April, 1, 1910, vol. I, Nr. 7, fq. 1.**

Artikull kritik kundër përkrahjes morale e materiale që qeveria turke u jep elementëve fanatikë e injorantë, mbrojtës të shkronjave arabe në gjuhën shqipe. Autori kritikon edhe Kongresin e Manastirit, i cili megjithëse bani një hap të madh përpara, tue i dhanë fund shumë alfabeve që ekzistonin deri atëherë, ai bani një gabim që adoptoi dy alfabe, në vend të një alfabeti të vetëm të detyrueshëm për të gjithë.

718. — **NJE OSHENAR NGA MALI SHENJT** (Pseudonim): /Letër Drejtorit të Lirisë/. — **LIRIJA, Selanik 18 Shënëndre 1910, Mot'i tretë, Nr. 107, fq. 3.**

Botohen 120 fjalë me përkthimin frangjisht, për të cilat A. mendon se këto fjalë kaluen nga shqipja në gjuhët frango-latine (!). (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

719. — **NJE ZEMER SHQIPTARE** (Pseudonim): Nga gazeta **Stamboul** 31.I.1910, Nr. 28. — **KORÇA, Korçë 30 Janar 1910, Vit'i I, Nr. 32, fq. 1.**

Artikull mbi «kongresin» e mbajtur nga një pjesë e parisë muhamedane të Shkupit në të cilin u vendos që në shkollat shqipe të mësohet shqipja me alfabetin arab. Ma poshtë A. shkruen se askush nga shqiptarët nuk do t'i ndjekë vendimet e këtij «kongresi», mbasi shqiptarët e të gjitha feve janë bashkue rreth Kongresit të Manastirit dhe alfabetit me shkronja latine të pranuem njëzani në këtë Kongres (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

720. — **NJE KLUB' i ri në Stamboll.** — **LIRIJA, Selanik 27 Shkurt 1910, Mot'i dytë, Nr. 77, fq. 2.**

Artikull mbi çeljen e një klubi në Aksaraj (Stamboll) për mësimin e shqipes me shkronja turke. Red. në një shënim të sajën shkruen se ky klub asht anmik i shkrimit shqip. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

721. — **NJE sy përmí krizën e abesë.** — **KORÇA, Korçë 25 mars 1910, Vit'i II, Nr. 2, fq. 1.**

Kryeartikull kushtue kalimit të krizës së alfabetit të shqipes. Mitingjet dhe qëndrimi i patundun i mbajtur këto kohë, thuhet ma poshtë, i treguen mbarë botës vendosmërinë e shqiptarëve të vërtetë për

të mbrojtun me çdo kusht alfabetin e vet. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

722. — NJI MITING kombëtar në Berat. — **TOMORRI, Elbasan 10 Mars 1910, Vjete I Nr. 1, fq. 4.**

Lajme mbi mitingun e Beratit kundër shkronjave arabe.

723. — NJI METING i bamun prejë Shqypëtarëve t'Korçës. — **BASHKIMI, Shkoder 6 Marc 1910, Vjeta e I, Nr. 10, fq. 2.**

Botohen lajme e telegrame dergue Klubit «Bashkimi» të Shkodrës mbi mitingun e madh të mbajtur në Korçë për mbrojtjen e shkronjave shqipe.

724. — **NOGGA, PHILIPPE: L'Ecriture albanaise et ses adversaires** [Shkrimi shqip dhe kundërshtarët e tij]. — **SHQIPETARI, Përa—Cons/ple (Turqi) 21 Janar 1910, Mot'i II, Nr. 4, fq. 1-2.**

Artikull kundër përkrahësve të alfabetit shqip me shkronja arabe. (Shih edhe Nr 651, 792).

725. — **NOSI, LEF: (Telegram).** — **KORÇA, Korçë 6 Shkurt 1910, Vit'i I, Nr. 34, fq. 1.**

Zyra e gaz. Korça dhe Lidhja Oorthodhokse njoftohen telegrafisht se në Elbasan u mbajt një miting prej 7.000 vetash për mbrojtjen e shkronjavet shqipe. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

726. — **NXENESIT** në Stamboll dhe gjuha shqipe. — **LIRIJA, Selanik 16 Janar 1910, Mot'i dytë, Nr. 71, fq. 2.**

Lajme mbi një deklaratë proteste të bame nga studentët e fakulteteve të teologjisë, të drejtësisë, të mjekësisë, të bujqësisë, të inxhinierisë, etj. kundër deputetëve, që kërkojnë futjen e shkronjave arabe-turke në gjuhën shqipe. (Informatë simbas *Jeni Gazeta* të Stambollit). (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

727. — **NXENESIT t'Idadies.** — **TOMORRI, Elbasan 10 Mars 1910, Vjetë I, Nr. 1 fq. 4.**

Mbi braktisjen e shkollës në shenjë proteste kundra shkronjavet arabe për gjuhën shqipe nga 23 nxanës (emnat e të cilëve botohen) të shkollës Idadie (gjimnazit) të Manastirit.

728. — **OR' e fundit** — **LIDHJA ORTHODHOKSE, Korçë 9 Shkurt 1910, Mot'i parë, Nr. 13, fq. 4.**

Njoftime mbi mitingun e Elbasanit dhe të Korçës për mbrojtjen e alfabetit të shqipes (me shkronja latine). (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

729. — **PELLASGU (Pseudonim): Nga Durrësi.** — **DIELLI, Boston, Mass. (USA) February 18, 1910, Vit'i II, vol. II, Nr. 47, fq. 2.**

Korrespondencë nga Durrësi mbi kundërshtimin që ka hasun në shkolla e në popull mësimi i shqipes me shkronja turke.

730. — **PELLASGU (Pseudonim): Deputetet t'ane dhe gjuha shqipe.** — **DIELLI, Boston Mass. (USA) March 4, 1910, Vit'i dyt, vol. II, Nr. 49, fq. 3.**

Artikull kundër qeverisë otomane dhe disa deputetëve shqiptarë, që kërkojnë futjen e shkronjave turke në gjuhën shqipe.

731. — **PELLASGU (Pseudonim): Mahmud Zeka. Myftiu i Kavajes (Nga Durrësi).** **DIELLI, Boston, Mass. (USA) March 18, 1910, Vit'i dyte, vol. II, Nr. 51, fq. 2** dhe **FLAMURI, Boston, Mass. (USA) March 18, 1910, vol. I, Nr. 5, fq. 2.**

Artikull kundër Mahmud Zekës, nga Kavaja, bimbash i redifëve (major i rezervës) i cili ka botue një abetar shqip me shkronja

- turke; si dhe kundër Myftiut të Kavajës, i cili ka telegrafue në Stamboll se populli i Kavajës me gjithë katundet nuk i duen shkronjat latine po shkronjat turke. A. përfundon se telegrami i sipërm asht një mashtrim i bam në emën të hoxhës e jo të popullit.
732. — PELLASGU (Pseudonim): /Letër e hapun gaz. «Bashkim'i i Kombit»/. — **BASHKIM'I KOMBIT**, Manastir 28 Kolozhek 1910, Vit'i I, Nr. 21, fq. 1.
- Kritikë kundër qeverisë otomane, e cila ka gisht në çeshtjen e alfabetit me shkronja arabe; njoftim se shumica e nuanësve të meqtepit të Durrësit kundërshtuen futjen e shkronjave arabe në mësimin e gjuhës shqipe.
733. — PER L'ALFABETO Albanese [Për Alfabetin Shqip]. — **LA NAZIONE ALBANESE**, Pallagorio (Catanzaro) Italia 15 Giugno 1910, Anno XIV, Nr. 11, fq. 4.
- Njoftime mbi vendimet që u muerën në Mbledhjen e Manastirit të dt. 21-23 mars 1910 në lidhje edhe me çeshtjen e alfabetit të shqipes.
734. — PER Gjuh shqype. — **BASHKIMI**, Shkoder 27 Fruer 1910, Vjeta e I, Nr. 9 fq. 2.
- Lajme të përmbledhuna nga Gazeta e Stambollit, Korça Liriya, **Bashkim'i Kombit**, **Shqiptari** në lidhje me mitingjet dhe protestat e bame për çeshtjen e shkronjave të alfabetit të shqipes.
735. — PERMETI, MEHMET, DH.A.: Letra. — **LIRIJA**, Selanik 13 Mars 1910, Mot'i dytë, Nr. 79, fq. 2.
- Lajme mbi mitingun e Permetit për mbrojtjen e shkronjavet shqipe. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
736. — PER shkronjat. — **KORÇA**, Korçë 30 Janar 1910, Vit'i I, Nr. 32, fq. 1.
- Artikull mbi kundërshtimin e përgjithshëm që hasi propozimi i disa deputetëve që të futen shkronjat turke në gjuhën shqipe. Ma poshtë thuhet se qeveria otomane mban qëndrim asnjanes ndaj këtij problemi tue u a lanë vet shqiptarëvet të zgjedhin këtë apo atë alfabet. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
737. — PER shkronjat shqip. — **LIRIJA**, Selanik 16 Janar 1910, Mot'i dytë, Nr. 71, fq. 1.
- Kryeartikull kundër deputetëve që propozuen futjen e shkronjavet turke në gjuhën shqipe. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
738. — PËR shkronjatë shqip. — **LIRIJA**, Selanik 13 Mars 1910, Mot' i dytë, Nr. 79, fq. 1.
- Lajme mbi mitingjet dhe protestat e bame në Gjinokastër, Prevezë, Berat, Përmet, Konicë e Janinë kundër futjes së shkronjave turke në gjuhën shqipe. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
739. — PRAPË shkronjat shqip. — **LIRIJA**, Selanik 30 Janar 1910, Mot'i dytë, Nr. 73, fq. 1.
- Kryeartikull për mbrojtjen e shkronjavet shqipe (alf. latin) dhe kundër intrigantëve që duen të ngatërrojnë shkronjat me fenë. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
740. — PREIE ministerit msoisimit (muarifit) i erdh hyqymetit. — **BASHKIMI**, Shkoder 20 Fruer 1910, Vjeta e I, Nr. 8, fq. 1.
- Artikull mbi mospërzimjen e qeverisë otomane në punët e alfabetit, tue lanë të lirë të shkruejë secili sipas dëshirës së vet (me

alf. latin ose arab). Red. shkruen se interesi i gjithë shqiptarëve asht të shkruajnë vetëm me alf. latin.

741. — PUNA dhe Bashkimi. — **LIRIJA**, Selanik 27 Shkurt 1910, Mot'i dytë, Nr. 77, fq. 1.

Kryeartikull mbi qëndrimin pro e kundra alfabetit të shqipes me shkronja latine. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

742. — PYETJE fjalësh. — **LIRIJA**, Selanik 9 Janar 1910, Mot'i dytë, Nr. 70, fq. 3, Nr. 71, fq. 3.

Hapet një rubrikë me titull «Pyetje fjalësh». Kërkoheft kuptimi në shqip i katër fjalëve turqisht (frangjisht), të cilavet u përgjigjet Sotir Kolea (nga Aleksandrija). (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

743. — QAF' E KOÇIUT (Pseudonim): Gjuha shqip me shkronja arabishte (Korrespondencë e rregullshme nga Vlora). — **FLAMURI**, Boston, Mass. (USA) March 25, 1910, Vol. I, Nr. 6, fq. 2-3.

Artikull kundër myftiut të Aidonatit, i cili ka kërkuë që vlonjatët muslimanë të shkruajnë shqipen me shkronja arabishte. A. këshillon të mos dëgjoheft anmiqt e përparimit, po të shkruajnë me alf. latin.

744. — QAF' E KOÇIUT (Pseudonim): Shkrimi i gjuhës shqipe edhe sulmi kombetar. — **DIELLI**, Boston, Mass. (USA) April 22, 1910, Vit'i dytë, vol. II, Nr. 56, fq. 1.

Korrespondencë mbi mitingjet e protestat e bame në Shqipni kundër shkronjavet turke.

745. — QYTETARI (Pseudonim): Miting i madh në Korçë prej 12.000 shpirt Per të mbrojtur abecenë kombëtare. — **BASHKIMI KOMBIT**, Manastir 18 Shkurt 1910 (1325), Vit'i I, Nr. 24, fq. 3.

Kronikë mbi mitingun e Korçës. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

746. — RAASA t'jashtme. — **BASHKIMI**, Shkoder 6 Fruer 1910, Vjeta e I, Nr. 6, fq. 4.

Njoftohet se në Shkup, në shkollën Idadie u vu mësimi i gjuhës shqipe me shkronja latine.

747. — RAULLASI, P.: Mbledhja e Shqipëtarëveft në Manastir. — **LIRIJA**, Selanik 27 Mars 1910, Mot'i dytë, Nr. 81, fq. 1-2.

Kronikë mbi mbledhjen e Manastirit dhe vendimet që u muerën në këtë mbledhje. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

748. — RRAS' E BARDHE (Pseud. i Josif Haxhimimës): Letra. — **LIRIJA**, Selanik 23 Janar 1910, Mot'i dytë, Nr. 72, fq. 2.

Nga Elbasani shkruhet se të dy klubet e këtij qyteti i derguen qeverisë telegrame në mbrojtje të alfabetit të shqipes. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

749. — RRAS' E BARDHË (Pseud. i Josif Haxhimimës): Letrë nga Elbasani. — **LIRIJA** Selanik 6 Shkurt 1910, Mot'i dytë, Nr. 74, fq. 2.

Korrespondencë nga Elbasani me këta nëntituj: 1) Shkronjat shqipe e kundërshtarët të pa-ditun, 2) Çashtja e «shkronjavet e Jeni Tanini», 3) Tejshkrim, 4) Haxhi Hafëz Sulejman Efendi. Në to flitet për përkrahësit dhe kundërshtarët e shkronjavet shqipe. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

750. — RRAS' E BARDHE (Pseud. i Josif Haxhimimës): Fjalëtor e vogëlë. — **LIRIJA**, Selanik 13 Mars 1910, Mot'i dytë, Nr. 79, fq. 3.

Diskutim mbi kuptimin e shprehjes **baj kabull**, e cila simbas Dok Sulës (A. Xhuvanit) shqip përkthehet me foljen **politís**. (Rubrika «Fjalëtor' e Vogëlë» asht vazhdim i rubrikës «Pyetje fjalësh» — shih Nr. 742). (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

751. — **RRAS' E BARDHË** (Pseud. i **Josif Haxhimimës**): Feja muslimane. Fleta **Tasvir-i Efqar**. — **LIRIJA**, Selanik 20 Mars 1910, **Mot'i dytë**, Nr. 80, fq. 2.

Artikulli mbi jehonën e mbrojtjes së shkronjave shqipe. Ribotohet në shqip e turqisht një copë nga gaz. **Tasvir-i Efqar** (Nr. 275) ku çeshtja e gjuhës përzihet me fenë. Në përgjigje A. shkruen se gjuha s'ka të bajë fare me fenë. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

752. — **RREZIKET'** e hidhurë të Shkronjavet t'Arapëvet ndë gjuhët t'onë. — **BASHKIM'I KOMBIT**, Manastir 4 Shkurt 1910 (1326), **Vi'i I**, Nr. 26, fq. 2.

Artikull kundër përdorimit të shkronjavet arabe në gjuhën shqipe, i cili do t'i sillte një rrezik të madh bashkimit të popullit shqiptar, tue i përça simbas fevet, etj. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

753. — **SAKOLI** (Pseud. i **Hil Mosit**): Çeshtja e alfabetit. — **LIDHJA ORTHODHOKSE**, Korçë 27 Janar 1910, **Mot'i parë**, Nr. 12, fq. 2.

Kritikohen disa nga deputetët shqiptarë, që kërkuene shkronjat arabe për alfabetin e shqipes. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

754. — **SAKOLI** (Pseud. i **Hil Mosit**): Alfabeti shqyp. Një këshill qeverisë dhe Turqve. — **LIRIJA**, Selanik 20 Shkurt 1910, **Mot'i dytë**, Nr. 76, fq. 2.

Artikull në mbrojtje të alfabetit shqip me shkronja latine dhe kundër alfabetit arab. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

755. — **SAKOLI** (Pseud. i **Hil Mosit**): Kongresi i Manastirit. — **LIDHJA ORTHODHOKSE**, Korçë 3 Prill 1910, **Mot'i parë**, Nr. 16, fq. 1-2.

Kronikë mbi punimet e Kongresit të Manastirit (mbajtur me 20 mars 1910) si dhe vendimet që u muerën në këtë kongres. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

756. — **SCHIRO, PAOLO**: Më i vjetëri shkronjës Shqipëtar i Njohur — 1555. **FLAMURI**, Boston, Mass. (USA) March 18, 1910, Vol. I, Nr. 5, fq. 1.

Botohet letra e Mons. Pal Skirojt, me anën e të cilës rektifikohet artikulli i gaz. **Dielli** (Shih Nr. 615). A. shkruen se ka në dorë dy vepra të tjera që kanë dalë para veprës së Budit e këto janë vepra e Dom Gjon Buzukut, shtypun më 1555 dhe vepra e Lukë Matrangës, shtypun më 1592.

757. — **SHKÂM I LETANIT** (Pseud. i **Simon Shuteriqit**): Nga Elbasani (Korrespondencë e Regullshme) — **DIELLI**, Boston Mass. (USA) March 25, 1910, **Vi'i dytë**, vol. II, Nr. 52, fq. 1-2 dhe **FLAMURI** Boston, Mass. (USA) March 25, 1910, vol. I, Nr. 6, fq. 1-2.

Me këta nëntituj: 1) Kryevepra e Haxhi Aliut në parlament, 2) Mitingu i xhonëve në Monastir, 3) Tradhëtari Hafes Kungulli dhe mitingu i fanatikëve n'Elbasan, 4) Mitingu i atdhetarëve n'Elbasan, 5) Nxanësit e idadies turqishte, 6) Atdhetari i madh Hasan be Prishtina dhe sherbimet e tij në Shqipni të sipërme. Korrespondenca ban fjalë mbi qëndrimin pro e kundër alfabetit të shqipes me shkronja latine. Autori shprehet pro shkronjave latine dhe kundër shkronjave arabe.

758. — SHKODRANI (Pseudonim): [Letër Redaksisë]. — **BASHKIMI**, Shkodër 30 Kallnuer 1910, Vjeta e I, Nr. 5, fq. 3.
- Letër mbi vendosjen e mësimit të gjuhës shqipe me shkronja arabe në mejtepin e Durrësit dhe mbi deklaratën e mësuesit të shqipes n'atë mejtep, Sali Nivica, se nuk di t'ua mësojë shqipen me atë alfabet.
759. — SHKOLLE shqip në Mitrovicë. — **LIRIJA**, Selanik 2 Janar 1910, Mot'i dytë, Nr. 69, fq. 1.
- Lajm mbi çeljen e një shkolle shqipe në Mitrovicë me drejtues Z. Basri Beqir Linoberi nga Gjinokastra. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
760. — SHKRIMI Shqip. — **SHQIPËTARI**, Péra — Cons/ple (Turqi) 14 Janar 1910, Mot'i II, Nr. 3, fq. 2; Nr. 5, fq. 2.
- Artikull përmbledhës mbi historikun e alfabetit të shqipes; mbahet qëndrim kritik ndaj përkrahësve të shkronjave arabo-turke për gjuhën shqipe; këshillohet përdorimi vetëm i shkronjave latine për alfabetin shqip.
761. — SHKRIMI shqip dhe shtypi. — **LIRIJA**, Selanik 30 Janar 1910, Mot'i dytë Nr. 73, fq. 2.
- Përmbledhje lajmesh pro dhe kundër alfabetit të shqipes me shkronja latine simbas gazetave **Jeni Gazeta**, **Sada-i-Ymet**, **Tanin**, **Neologos**, **Frankfurter Zeitung** dhe **Osmanischer Lloyd**. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
762. — SHKRIMI shqip dhe shtypi turqisht. — **LIRIJA**, Selanik 16 Janar 1910, Mot'i dytë, Nr. 74, fq. 2.
- Artikull mbi polemikën pro e kundër alfabetit të shqipes me shkronja latine në shtypin turk (**Jeni Asr**, **Ikdam**, **Sabah**, **Xhon Tyrk** dhe **Jeni Tanin**). Botohet artikulli i gaz. **Jeni Tanin**, telegrami i Shahin Kolonjës dhe letra e Hasan Prishtinës që flasin në mbrojtje të alfabetit shqip me shkronja latine. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
763. — SHKRIMI shqip dhe shtypi greqisht. — **LIRIJA**, Selanik 20 Mars 1910, Mot'i dytë, Nr. 80, fq. 2.
- Mbi një artikull të botuem në gaz. **Neologos** të Stambollit, nga Kristo Vasili, i cili shkruen në favor të alfabetit të shqipes me shkronja latine dhe kundërshtimi që i bahet në gaz. **Nea Alithia** të Selanikut. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).
764. — SHKRONJAT arabishte e llatinishte. — **SHQIPETARI**, Péra — Constantinople (Turqi) 25 Dhjetor 1910, Mot'i II, Nr. 44, fq. 2.
- Diskutim pro dhe kundër alfabetit të shqipes me shkronja latine në gaz. **La Dépêche Tunisienne** (Nr. 7423).
765. — SHKRONJAT Shqipe. — **BASHKIM' I KOMBIT**, Manastir 28 Kolozhek 1910, Vit'i I, Nr. 21, fq. 1.
- Botohet kopja e telegramit që qeveria turke u ka dergue të pesë Vilajeteve me të cilin njoftohet lanja lirë e mësimit të shqipes me alfabetin latin ose arab.
766. — SHKRONJAT shqip dhe shtypi. — **LIRIJA**, Selanik 9 Janar 1910, Mot'i dytë, Nr. 70, fq. 2.
- Artikull mbi polemikën në mes të gazetave të Stambollit **Tanin**

dhe **Ikdam** për çeshtjen e shkronjave (arabe ose latine) të alfabetit të shqipes. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

767. — **SHOQERI** Shqipëtare. — **LIRIJA**, Selanik 6 Shkurt 1910, Mot' i dytë, Nr. 74, fq. 3.

Lajm mbi themelimin në Syrakuse N. Y. (SH. B. A.) të shoqërisë shqiptare me emnin «Shoqërija Shqip Mirë-bërëse» me kryetar Jorgji Xhaxhollar Kotoni. Qëllimi i kësaj shoq. asht të punojë për shkollat shqipe dhe mësimin e gjuhës shqipe. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

768. — **SHORDJA** për njizet e një vjeçat... 22 vjeçat... 23 vjeçat. — **BASHKIM**, Shkoder 20 Nanduer 1910, Vjeta e I, Nr. 47, fq. 4, Nr. 48, fq. 1-3, Nr. 49, fq. 2.

Onomastikë. Botohet lista emnore e rekrutave të qarkut të Shkodrës dhe e vendbanimevet të tyne.

769. — **SHPATARAKU** I **SHPATES** (Pseudonim): Letër prej Elbasani. — **SHQYPEJA E SHQYPENIS**, Sofië më 6 të Shkurtit 1910, Nr. 17, fq. 2.

Letër drejtue drejtorit të kësaj gazete, Josif Bagërit, me të cilën kritikohen deputetët që kërkuene futjen e shkronjave arabe në gjuhën shqipe.

770. — **SHPATARAKU** **NGA SHPATI** (Pseudonim): Ali Hoxha deputet i Elbasanit. — **BASHKIMI** I **KOMBIT**, Manastir 22 Kolozhek 1910, Vit'i I, Nr. 21, fq. 2.

Kritikë deputetit Ali Hoxha, i cili, kundër dëshirës së popullit, ka kërkuë në parlament alfabetin arab për shkronjat shqipe.

771. — **SHPIRTI** I **REKES** (Pseudonim): Letër prej Gostivari. — **SHQYPEJA E SHQYPENIS**, Sofië më 11 të marsit 1910, Mot'i par, Nr. 19, fq. 3.

Letër mbi persekutimin që u bahet prej njerëzve të përkrahun nga qeveria mbrojtësve të alfabetit të shqipes me shkronja latine.

772. — **SHQIPERIA** e ndarë. — **LIDHIJA** **ORTHODHOKSE**, Korçë 22 mars 1910, Mot'i parë, Nr. 15, fq. 2.

Riprodhohet artikulli me të njejtin titull botue në gaz. **Journal de Salonique**, nënëshkrue nga «Një Albanofil», në të cilin autori shkruen kundër alfabetit të shqipes me shkronja arabe dhe në favor të alfabetit latin (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

773. — **SHQIPJA** në Turqi. — **DIELLI**, Boston, Mass. (USA) January 28, 1910, Mot'i parë, vol. I, Nr. 44, fq. 3.

Njoftohet se në **Milqieh** (Shkollë administrative) të Stambollit u vu mësimi i gjuhës shqipe, me profesor Z. Sabri Qytezën.

774. — **SHTYLLE** gjuhësore. — **SHKREPTIMA**, Kairo 28/11 Shendre (1910), Vit'i I, Nr. 11, fq. 7.

Shënime mbi kuptimin e përdorimin e fjalës **vandak** (dhe sjetull a sjetull).

775. — **SQIROI**, **PAAL**: **Copë e marrun nga libri i Dom Gjon Buzukut**. Fletë Nr. 53, shtyllë 2, viza 6.. 33. Këthier nga libri III t'Regjëvet krye XVII 17.. 24 (të Dhjatës së Vjetës) 1555. — **TOMORRI**, Elbasan 30 Qershter 1910, Vjetë I, Nr. 12, fq. 3.

Botohet copa e sipërme simbas ortografisë së origjinalit dhe i kthym në versionin e të folmes së «Hora e t'Arbëreshevet» (Piana dei Greci) të vjetit 1910, — pajisun me shënime gramatikore.

776. — **T'NOLLUNA** Zyrtare. — **BASHKIMI**, Shkoder 6 Marc 1910, Vjeta e I, Nr. 10 fq. 4.

Telegram i E. Toptanit, deputet në Stamboll, drejtue parisë katolike të Shkodrës, me anën e të cilit i siguron se do të mbrojtë çesh-tjen e shkronjavet kombëtare (alf. latin).

777. — **TEJSHKRIM**: Vezirit të Math, depytenjve Ismail Qemal be Vlora, Aziz Pasha Vrionit, Esad Pasha Shkodrës, Hasan be Prishtinës, Nexhip be Dragës, Myfit be Gjirokastrës, Shahin be Kolonjës, Gani be Frashërit, Ali Hajdar beut dhe gazetës «Shqipëtar». — **KORÇA, Korçë 8 Prill 1910, Vit'i II, Nr. 4, fq. 1.**

Telegram proteste kundër ndjekjeve që qeveria asht tue ba ndaj organizatorëve të mitingut të Korçës për mbrojtjen e alfabetit të shqipes. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

778. — **TEJSHKRIM** nga Klub'i Selanikut në Sadaret, ministori e brëndëshme, e mësimt të përgjithshëm dhe në gazeta **Tanin**. — **LIRIJA, Selanik 6 Shkurt 1910, Mot'i dytë, Nr. 74, fq. 1.**

Telegram (në gjuhët shqip e turqisht) drejtue enteve të nalpërmenduna në mbrojtje të alfabetit të shqipes me shkronja latine. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

779. — **TEJSHKRIM** nga Elbasani. — **LIRIJA, Selanik 6 Shkurt 1910, Mot' i dytë, Nr. 74, fq. 1.**

Telegram mbi mitingun e madh që u mbajt në Elbasan për mbrojtjen e shkronjavet shqipe. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

780. — **TEL** nga Shkodra. **SHQIPETARI Përa** — **Cons/ple (Turqi) 11 Shkurt 1910, Mot'i II, Nr. 7, fq. 2.**

Telegram i katolikëve të Shkodrës dërgue në shenjë solidariteti me deputetët mbrojtës të alfabetit të shqipes me shkronja latine.

781. — **TEL** nga Delvina. — **SHQIPETARI, Përa** — **Cons/ple (Turqi) 4 Mars 1910, Mot'i II, Nr. 10, fq. 2.**

Telegram proteste i popullit të Delvinës dërgue qeverisë kundër futjes së shkronjave arabe në gjuhën shqipe.

782. — **TELEGRAF**. — **BASHKIM'I KOMBIT, Manastir 25 Shkurt 1910, (1325), Vit' i I, Nr. 25, fq. 2.**

— 1. Telegram i Klubit «Drita» të Gjinokastrës, me anën e të cilit njoftohet se populli i Gjinokastrës asht i vendosun të mbrojtë gjer në fund shkronjat shqipe (alf. latin).

— 2. Telegram dhe një letër dërgue deputetëve shqiptarë nga një grup shkodoranësh, n'emën të katolikëve të Shkodrës, në mbrojtje të shkronjavet shqipe që ka pëlqye Kongresi i Manastirit.

783. — **TELEGRAFE** të veçantë të Bash. Kom. Miting për të mbrojtur shkronjat shqip. — **BASHKIM'I KOMBIT, Manastir 11 Shkurt 1910 (1325), Vit'i I, Nr. 23, fq. 2.**

Telegram mbi mitingun e madh të organizuem në Elbasan kundër shkronjave arabe në gjuhën shqipe. Jepen hollësina mbi këtë miting.

784. — **TELEGRAFE** të veçan. të Bash. Kom. — **BASHKIM'I KOMBIT, Manastir 4 Mars 1910 (-1326), Vit'i I, Nr. 26, fq. 1.**

1. Telegram proteste dërgue ministrit turk të arësimit kundër futjes së shkronjave arabe në mësimin e gjuhës shqipe;

2. Njoftime mbi mitingun e madh të Beratit, në të cilin u dogjën abetaret me shkronja arabe, etj.

785. — **TE DALE** në shesh e vërteta. Qeverisë dhe depytetëvet. — **LIRIJA Selanik 13 Shkurt 1910, Mot'i dytë, Nr. 75, fq. 1.**

Artikull mbi qëndrimin e autoriteteve lokale, të cilët në kundërshtim me urdhnin e qeverisë, po ndalojnë përdorimin e shkronjave latine, tue ndërhye të përdoret për mësimin e shqipes vetëm alfabeti arab. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

786. — TE 2 Mitingjet per shkronjat shqip. — **SEPATA, Tubhar-Fayoum, H. Egypte 1 Prill 1910, Nr. 1, fq. 2.**

Lajme mbi dy mitingjet që u mbajtën në Elbasan dhe në Korçë për mbrojtjen e alfabetit të shqipes.

787. — TE RA të Shkurtëra. — **LIRIJA, Selanik 9 Janar 1910, Mot'i dytë, Nr. 7 fq. 3.**

Rekomandohet të lexohet gaz. **Jeni Asr** e Selanikut (Nr. 1774 dt. 15-I-1910), në të cilën asht shkruar një artikull i gjatë në favor të alfabetit të shqipes me shkronja latine. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

788. — TE RA të javës. — **SHQIPETARI, Përa — Consjpie (Turqi) 15 Shkurt 1910, Mot' i II, Nr. 7, fq. 2.**

1. Njoftime simbas gaz. **Politischen Correspondenz** e Vjenës mbi masat që qeveria otomane asht tue marrë kundër lëvizjes në rritje e sipër të Shqipëtarëve për mbrojtjen e shkronjave kombëtare.

2. Lajme nga Korça mbi braktisjen e shkollës nga 46 nxanës të shkollës turke Idadie në shenjë proteste kundër futjes së shkronjave arabe në mësimin e gjuhës shqipe.

789. — TE RA të shkurtëra. — **LIRIJA, Selanik 20 Shkurt 1910, Vit'i dytë, Nr. 76, fq. 3.**

Lajme nga Permeti, Dibra, Bosnja, Korça e Shkupi mbi lëvizjen pro e kundër alfabetit të shqipes me shkronja latine. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

790. — TE RA të shkurtëra. — **LIRIJA, Selanik 27 Shkurt 1910, Mot'i dytë, Nr. 77, fq. 2.**

Lajme nga Kumanova e Mitrovica mbi lëvizjen pro e kundër alfabetit të shqipes me shkronja latine. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

791. — TE RA të shkurtëra. — **LIRIJA, Selanik 6 Mars 1910, Mot'i dytë, Nr. 78, fq. 2.**

Lajme (telegrame e letra) nga Shkodra, Filati, Vlona, Tirana, Kruja e Kavaja në mbrojtje të alfabetit të shqipes me shkronja latine. Në fund shkruhet se në gaz. **Progrès de Salonique** asht botue nga Mid'hat Frashëri një artikull i gjatë për çeshtjen e shkronjavet shqipe. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

792. — TE SHKRUARAT e gjuhës Shqip e kundërshtarët e saj. — **BASHKIM' I KOMBIT, Manastir 18 Shkurt 1910 (—1325), Vit' i I, Nr. 24, fq. 1.**

Botohet i përkthym në shqip artikulli i Filip Nogës, shkruar frangjisht në **Shqipetari** (Shih ed e Nr. 651, 724), (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

793. — **TOPTANI, REFIK, S.: Letr'e hapur. — BASHKIM' I KOMBIT, Manastir 14 Kolozhek 1910, Vit' i I, Nr. 19, fq. 1-2.**

Letër kundër deputetëve, që kërkueen futjen e shkronjavet turke në gjuhën shqipe.

794. — **TOPTANI, R. S.: Letër e hapur nga Tirana. — KORÇA, Korçë 15 Janar 1910, Vit' i I-rë, Nr. 30, fq. 1-2; Nr. 31, fq. 1.**

Për përmbajtjen shih Nr. 793. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

795. — TRABOINA, PALOK: Giunija e Kombit shqypetar. — **BASHKIMI, Shkoder 17 prill 1910. Vjeta e I, Nr. 16, fq. 2-3; Nr. 17, fq. 3.**
 Artikull divulgativ mbi prejardhjen pellazgjike të popullit shqiptar.
796. — TRATHETORE ose të çmendur. — **LIDHJA ORTHODHOKSE, Korçë 15 Janar 1910, Mot'i parë, Nr. 11, fq. 2.**
 Artikull kundër përkrahësve të alfabetit të shqipes me shkronja arabe. (Shkrue me alf. e «Stambollit».)
797. — U.N.Ë. (Pseudonim): Vendimet Nde Kongre të Manastirit. — **ZGJIMI SHQIPERISE, Janinë 5 Prill 1910, Mot'i I, Nr. 75, fq. 1.**
 Jepet një përmbledhje e vendimevet që u mbajtën në Mbledhjen e Manastirit të 20 marsit 1910. (Shkrue me alf. e «Stambollit».)
798. — UN CONGRESSO linguistico albanese in Italia [Një Kongres gjuhësor shqiptar në Itali]. — **LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia 30 Novembere 1910, Anno XIV, Nr. 22, fq. 1-2.**
 Artikull mbi nevojën e mbajtjes së një kongresi gjuhësor nga shqiptarët e Italisë në lidhje me qëndrimin që duhet mbajtur rreth çështjes së alfabetit të shqipes. Në lidhje me këto ngjarje botohen lajme nga gaz. **Dielli dhe Flamuri.**
799. — URDHER' I ministorit Talat be që të mos përzejehen nëpunësit e qeverisë në shkronjat shqipe. — **LIRIJA, Selanik 23 Janar 1910, Mot'i dytë, Nr. 72, fq. 1.**
 Njoftohet se ministri i mbrendëshëm, mbi kërkesën e Hasan Prishtinës, u dha urdhën telegrafik të katër vilajeteve me porosi që nëpunësit të mbajnë qëndrim asnjans në çështjen e alfabetit të shqipes. (Shkrue me alf. e «Stambollit».)
800. — URDHËR' i Ministorit të Mësimimit. Qeverija po rri e paantë. — **LIRIJA, Selanik 30 Janar 1910, Mot'i dytë, Nr. 73, fq. 1.**
 Botohet urdhëni i ministrit turk të arësimit dergue të pesë Vila-jeteve (Selanik, Kosovë, Manastir, Janinë e Shkodër) me porosi që mësimi i gjuhës shqipe të bahet me alfabetin latin ose arab, simbas dëshirës. (Shkrue me alf. e «Stambollit».)
801. — V.D.: Intrigat' e Sërbeve në Shqipëri. — **LIRIJA, Selanik 6 Shkurt 1910, Mot'i dytë, Nr. 74, fq. 1-2.**
 Artikull kundër përkrahjes morale që disa deputetë serbë po u japin kundërshtarëvet të alfabetit të shqipes me shkronja latine. (Shkrue me alf. e «Stambollit».)
802. — VINI Re. — **LIRIJA, Selanik 6 Shkurt 1910, Mot'i dytë, Nr. 74, fq. 4.**
 Informacion bibliografik mbi daljen nga shtypi të vëllimit «Ferrëfjës i ri» a «Mësimet Myslimane» fq. 64 përmbledhë e shkruar nga J.H.M. në dialekt të Elbasanit. Në fund gjindet edhe një fjalorth shqip-turqisht. (Ky njoftim përsëritet në disa numra). (Shkrue me alf. e «Stambollit»)
803. — XEXO, A.N.: Shtylla literare. — **LIRIJA, Selanik 19 Qershor 1910, Mot'i dytë, Nr. 92, fq. 3.**
 Mbi kuptimin e përdorimin e fjalës **merak**, që i përgjigjet shqipes **vrahthie** (vrahthija), si dhe për fjalët **llazë** (thikë e gjatë dhe e madhe) dhe **rogominë** (plak i thinjur). Ma poshtë jepen edhe disa shënime ortografike për tingullin **nj**. (Shkrue me alf. e «Stambollit».)
804. — XHAHID, HYSEJN: ç'thotë për shkronjat shqip. — **KORÇË, Korçë 15 Janar 1910, Vit'i I-rë, Nr. 30, fq. 3.**

Botohet një pjesë e artikullit të shkruar nga turku H. Xhahid për çeshtjen e alfabetit të shqipes, marë nga gazeta turke **Jeni Tanin**, Nr. 27. Simbas A., shqiptarët do të përparonin shumë ma tepër me alfabetin latin, se sa me alfabetin turk. Ai shprehet kundër disa bashkatdhetarëve të vet, të cilët çeshtjen e alfabetit e ngat-rojnë me punët e fesë, etj. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

805. — XHUVANI, ALEKSANDËR: Stulle gjuhsore. — **SHKREPTIMA, Kairo, Vjesht' e Tretë [1910], Vit' i I, Nr. 8, fq. 3-4.**

Çelet rubrika për çeshtje gjuhësore, mbi pasunimin e leksikut të shqipes dhe mbi pastrimin e gjuhës shqipe nga fjalët e hueja. Në këtë numër shkruhet për fjalën **qejl** (turq.) dhe shprehjet në gjuhën shqipe të formueme me këtë fjalë. (Në fq. 5-6 jepet një përmbledhje në gjuhën greke: **Glossologiki Stili**).

806. — YLLI me bisht. — «**LAHUT'E MALSIS**». Manastir Shkurt 1910, **Mot'i parë, Nr. 2, fq. 14-15.**

Artikull kundër përdorimit të alfabetit me shkronja arabe në gjuhën shqipe. (Shkrue me alf. e «Stambollit»)

807. — Z. M.: Metingat. — **BASHKIMI, Shkoder 6 Marc 1910, Vjeta e I, Nr. 10, fq. 2.**

Artikull mbi mitingjet që u mbajtën në Shkup (pro) dhe në Elbasan e Korçë (kundër) alfabetit arab për gjuhën shqipe. Mitingjet të tilla kundër shkronjavet arabe përfundon artikulli duhet të bahen edhe në Shkodër e në qytete tjera të Shqipnisë.

808. — Z. M.: Alfabeti kombëtar. — **BASHKIMI, Shkoder 10 Prill 1910, Vjeta I, Nr. 15, fq. 2.**

Artikull kundër veprimit të bamun nga krahu musliman i Beledies (Bashkisë) së Shkodrës, i cili, pa u këshillue me krahun e krishtenë, i ka dergue telegram Shkupit tue shpreh n'emën të popullit të Shkodrës pëlqimin e vet për futjen e alfabetit arab në gjuhën shqipe.

809. — KONGRESI i Ianines. — **BASHKIMI, Shkoder 12 Qershuer 1910, Vjeta e I, Nr. 24, fq. 3.**

Shkruhet se Kongresi i ardhshëm i Janinës do t'i japë fund çeshtjes së alfabetit të shqipes, tue e bashkue kombin shqiptar me një alfabet të vetëm, kombëtar.

810. — ZADHËNJE. — **BASHKIM'I KOMBIT, Manastir 8 Prill 1910 (-1326), Vit'i I, Nr. 31, fq. 3.**

Njoftohet se shoqnia «Dija» e Vjenës nxori nga shtypi vëllimin **Bibliograifa Shqype** (e Ing. F. Manek, Dr. G. Pekmezi dhe A. Stotz). Kjo shoqni premtan se së shpejti do të dalë edhe Bibliografia tjetër e dytë, e cila do të jetë edhe ma e plotë se e para. (Ky njoftim përsëritet në disa numra).

811. — [ZANONI, ANTON]: Çka na duhet nee gramatika? — **ELCIJA I ZEMERS T'J. KRISCTIT, Skoder shtator 1910, Pj. II, Nr. IX, fq. 120-132.**

Artikull mbi randësinë dhe rolin që luejnë gramatikat në mësimin me themel të gjuhës dhe mbi nevojën e studimit të dy dialekteve të shqipes, në mënyrë që të arrihet sa ma shpejt në bashkimin e tyre, në dobi të leteraturës shqiptare.

812. — [ZANONI, ANTON]: Saa Fialorë kaa Shqypia? — **ELCIJA I ZEMERS T'J. KRISCTIT, Skoder dhetor 1910, Pj. II, Nr. XII, fq. 183-186.**

Artikull mbi randësinë që kanë fjalorët për mësimin e gjuhës dhe

mbi nevojën për një fjalor të gjuhës shqipe. Rekomandon artikullin e Shtjefen Gjeçovit botue në gaz. **Dashamiri** (Shih Nr. 485) në lidhje me randësinë e dobënë e fjalorëvet. Boton një listë prej 19 fjalorësh tue fillue me fjalorthin e fon Harfit, 1496, e deri tek fjalorthi i L. Grudës, (1906) tue vue në dukje se asnjëni prej tyne nuk asht i plotë. Shtron nevojën e mbledhjes së leksikut nga goja e popullit dhe botimin e tij, me qëllim që në të ardhmen të sherbejnë për botimin e Fjalorit të gjuhës shqipe.

813. — ZEDHENJE. — **BASHKIM**, Stamboll 30 vjeshtë II, 1910, Mot'i II, Nr. 5, fq. 2.

Mbi botimin nga Eqrem Vlora të librit mbi abecenë e gjuhës shqipe, **Shënime për mi shkrimin e vjetër Pellazgjisht**, përkthye mbas veprës së Dr. Hahnit. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

814. — ZEDHENJE. — **BASHKIM' I KOMBIT**, Manastir 4 Mars 1910 (—1326), Vit'i I, Nr. 26, fq. 2.

Lajm mbi ftesën e Klubit Qendror të Manastirit dërgue gjithë klubevet të Shqipnisë në lidhje me nisjen e delegatëvet të tyne në mbledhjen e 15 marsit, për të bisedue rreth çeshtjes së alfabetit të shqipes. (Shkrue me alf. e «Stambollit»).

